

PROCESVERBAL

I mbajtur sot, në dt. 25.02.2026, në orën 11:00, në sallën e këshillit bashkiak, në Pallatin e Kulturës Lezhë, mbi mbledhjen e radhës të muajit Shkurt 2026, të Këshillit të Bashkisë Lezhë.

Mbledhja u hap nga kryetari z. Ndue Luli, i cili lexoi rendin e ditës dhe tre projektvendime shtesë.

-Ndue Luli: Përshëndetje të gjithëve. Faleminderit për pjesëmarrjen.

Sot kemi mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Lezhë për muajin Shkurt 2026. Mbledhja zhvillohet me këtë rend dite:

1. Projekt-Vendim “Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 01-31 Janar 2026”
2. Projekt-Vendim “Për një shtesë në VKB nr. 113, datë 15.12.2025 “Për miratimin e PBA-së 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026””
3. Projekt-Vendim “Për miratimin e pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë, të punonjësve administrativë, të punonjësve mbështetës dhe të masës së shpërblimit mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave”
4. Projekt-Vendim “Për miratimin e Raportit për Vlerësimet dhe Parashikimet Afatmesme të të Ardhurave për Programin Buxhetor Afatmesëm 2027-2029”
5. Projekt-Vendim “Për miratimin e prioriteteve dhe projekteve për investime në kuadër të përgatitjes së PBA-së 2027-2029 dhe të buxhetit të vitit 2027”
6. Projekt-Vendim “Për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor kombëtar, shoqërisë One Albania sha, për antenat e telefonisë celulare, fshati Balldre, Njësia Administrative Balldre dhe fshati Mabë, Njësia Administrative Dajç, Bashkia Lezhë”
7. Projekt-Vendim “Për miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2026-2030”
8. Projekt-Vendim “Për miratimin e Marrëveshjes së Konsorciumit ndërmjet “AURIVE” Agjencisë Ekzekutive Evropiane të Arsimit dhe Kulturës, Itali (koordinatori projekti) dhe Bashkisë Lezhë (partner projekti) për projektin “Tempus, Spiritus i Tokës (TsiTokës)””
9. Projekt-Vendim “Për ngritjen e Këshillit Artistiko-Kulturor dhe Turistik për periudhën 2026-2028”
10. Projekt-Vendim “Për ndryshimin e emërimit të rrugës nga “Luigj Deda” në “Gjonaj””
11. Projekt-Vendim “Për ndryshimin e emërimit të rrugës nga “Ivanaj” në “Luigj Deda-Ivanaj””
12. Të ndryshme

Përveç këtyre, kemi dhe tre projektvendime shtesë si më poshtë.

Projektvendim “Për vënien në dispozicion dhe kalimin në pronësi të një apartamenti në favor të familjes përfituese, në kuadër të procesit të rindërtimit”.

Projektvendimi i dytë shtesë “Për një ndryshim në VKB nr. 115, datë 26.10.2020 “Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në

ndërtesa (palate) me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5 sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë”.

Projektvendimi i tretë është “Për përcaktimin e datave të reja për zgjedhjet e anëtarëve të kryesisë dhe të kryetarëve të fshatrave në fshatrat Tresh, Kodër Mulliri dhe Krajën”.

Këto janë të gjithë projektvendimet që kemi në mbledhjen e sotme.

Duhet të sqaroj se dy projektvendimet që janë në njoftim që kanë të bëjnë me ndryshimin e emërtesave të rrugëve për arsye teknike, bëjmë thirrje që t'i tërheqim, pra mos t'i marrim në shqyrtim në këtë mbledhje. Pra, bëhet fjalë për projektvendimet nr. 10 dhe nr. 11 sipas njoftimit që keni, kurse të tjerat janë siç i lexuam.

Ka kush diçka për rendin e ditës? Po, zonja Marku.

-Alfrida Marku: Faleminderit. Së pari mendoj që pika 6 “Për dhënien në përdorim të fondit pyjor për vendosjen e antenave të telefonisë celulare në Balldre dhe Dajç” nuk duhej përfshirë në rendin e ditës, sa kohë që kjo nismë në mbledhjen e kaluar u hodh për votim dhe nuk u miratua nga anëtarët e Këshillit Bashkiak dhe si e tillë ajo tashmë është gjë e gjykuar. Nuk kemi një vendim nga ana e Prefektit të Qarkut që orienton apo sugjeron Këshillin Bashkiak për ta rishqyrtuar, si dhe bazuar në parashikimet e rregullores mbi të cilën funksionon Këshilli Bashkiak, shtuar dhe argumentat e sapo përmendura, kjo çështje, sikurse e thashë, nuk duhej përfshirë në rendin e ditës, duke mos harruar dhe faktin se në dokumentacionin e vënë sot në dispozicion nuk kemi asnjë element, asnjë dokument shtesë të paraqitur nga drejtoria përkatëse apo nga subjekti. Sikurse e kam theksuar dhe në mbledhjen e kaluar, ne nuk duhet të nënshtrohemi në diskutimin e kësaj çështjeje por të marrim nismën për rishikimin e lejeve mjedisore dhe rishikimin e vendndodhjes së kësaj infrastrukture të telefonisë celulare për shkak të rrezatimit të dëmshëm të përditshëm që shkakton tek qytetarët.

Së dyti, në mbledhjen e radhës të datës 28 janar kam kërkuar që në mbledhjen e Këshillit Bashkiak të thirrej institucioni Agjencia Shtetërore e Kadastrës, drejtoria vendore e Lezhës, për të raportuar mbi vonesat e paarsyeshme tej çdo afati parashikuar në ligj, tej çdo argumenti nga ana e punonjësve, sa i përket pengesës së qytetarëve për t'u pajisur me dokumentat e pronësisë për tokën bujqësore në procedurat e kalimit nga përdorim në pronësi të tyre.

Për këtë dhe problematika të tjera, unë mbi bazën e shumë shqetësimeve të marra nga qytetarët, me të drejtë shpreh në këshill që ky institucion është kthyer në pengesë për hallet e qytetarëve.

Për ta përmbledhur, kërkoj përjashtimin nga rendi i ditës të pikës 6, si dhe kërkoj mirëkuptimin që në mbledhjen e radhës të thirret për të raportuar në këshill Agjencia Shtetërore e Kadastrës dega Lezhë. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Ka mendim tjetër për rendin e ditës?

Sqarimi për këshilltaren dhe për të tjerët. Në lidhje me pikën 6, nuk ka asnjë nen në ligjin “Për Vetëqeverisjen Vendore” që e ndalon për të mos u futur në rendin e ditës. Kjo ka të bëjë edhe me kërkesën që ka dhe bashkia, ka të bëjë edhe me dëgjuesën publike që është zhvilluar në fshatrat për të cilët janë në dijeni këshilltarët. Dhe duke u nisur nga kjo, e fusim në rendin e ditës sot për ta miratuar. Sot, kemi edhe kryetarin e fshatit Mabë të ftuar në mbledhjen e këshillit, kështu që mund të flasë edhe fjalët e veta kur të vijë radha e projektvendimit për ta miratuar. Në lidhje me

informacionet që thotë zonja Marku, është e vërtetë që ka kërkuar të thirret në këshill Agjencia Shtetërore e Kadastrës, dega Lezhë, duke pasur për bazë e para agjendën që ka Këshilli Bashkiak sipas planit vjetor për informacionet që sillen në këshill, ku ne kishim faktikisht drejtorinë e OSHEE-së dhe drejtori na ka dërguar një informacion, që për shkak të ngarkesës që kemi sot, nuk e kemi futur fare informacionin dhe duke pasur ngarkesën që po e shikoni vetë se çfarë kemi sot, nuk e kemi njoftuar fare Agjencinë e Kadastrës për të dhënë informacion. Do të jetë, ta kemi të qartë.

Kush është dakord me rendin e ditës, ju lutem kartonat. Duke heqë dy projektvendimet e fundit, 10-11 siç thashë, dhe duke shtuar dhe tre të tjerë. Ju lutem kartonat. Kundra? Një. Abstenim? Një. Dy. Atëherë me një kundra dhe dy abstenime, Miratohet me 28 vota Pro. Këshilltarët Alfrida Marku dhe Soveljan Kosova votuan Kundër, pra dy vota Kundër. Këshilltarët Rrok Marku dhe Gjon Marku votuan Abstenim, pra 2 vota Abstenim. Këshilltari Emanuel Perjaku nuk votoi. Faleminderit.

Vazhdojmë me pikën e parë, Projektvendim "Për përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6% për periudhën 1-31 janar 2026".

Kush është dakord? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 33 vota Pro. Faleminderit.

Kalojmë te pika 2, Projektvendim "Për një shtesë në VKB nr. 113, datë 15.12.2025 "Për miratimin e PBA-së 2026-2028 dhe Buxhetit Vjetor 2026".

Në lidhje me projektvendimin, fjalën e ka kryetari i komisionit të financës.

-Agostin Marku: U diskutua edhe dje në mbledhjet e komisioneve, dy komisione vazhduan punën së bashku, komisioni juridik dhe komisioni i financës. Ramë dakord për ta kaluar. Është një projektvendim që vjen nga Drejtoria e Shërbimit Social dhe ka të bëjë me një grant që është dhënë nga strukturat e qeverisë. Thjesht do të bëhen shtesa, pakësime, duke u integruar në buxhetin e vitit 2026. Pra, jemi dakord që ta kalojmë. Është në përputhje me ligjin dhe me gjithçka tjetër. Faleminderit.

-Ndue Luli: Po, zonja Ndoj.

-Donika Ndoj: Përshëndetje të gjithëve. Për sa i përket këtij projektvendimi, e mirëpresim çdo mbështetje për fëmijët sidomos, apo për përkujdesje sociale apo për fëmijët me aftësi të kufizuara. Këtu bëhet fjalë për dy projekte sociale në lidhje me "Tungjatjeta jetë" shërbimi lëvizës dhe përmirësimin e aksesit në shërbimet komunitare dhe shërbimet multifunksionale. Njëkohësisht flasim për 30% thotë bashkëfinancim që jep ministria dhe thotë: "A është i mjaftueshëm pikërisht ky për këto dy projekte dhe a ka fonde shtesë nga bashkia?" Realisht ne këtu flasim për fonde, paga, sigurime, honorare, trajtime të tilla për sa i përket këtyre shërbimeve. Por unë dua të ngre disa shqetësime në lidhje me shërbimet. Përpos vullnetit të mirë të drejtoreshës zonjës Fetaj, dua të ngre disa shqetësime nga këta prindër që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara.

A mjaftojnë 45 minuta në javë për të marrë trajtim dhe shërbim këta fëmijë? 45 minuta në javë apo 45 minuta në 24 orë për fëmijët me aftësi të kufizuara? Dhe ndërkohë që këta fëmijë shoqërohen nga prindërit dhe zakonisht nga njëri prind, nëna zakonisht, dhe për këta prindër, a ka ambiente pritëse ku do të qëndrojnë këta fëmijë? Dhe së treti, duke qenë se flasim për shërbim

lëvizës, këto nëna apo prindër që shoqërojnë këta fëmijë, a ju sigurohet ndonjë transport apo mbështetje logjistike apo financiare për këta fëmijë? E marr shkas pikërisht nga disa shqetësime që i kanë ngritur vetë prindërit që kanë këta fëmijë me aftësi të kufizuar. Jemi pro çdo projekti i cili mbështet përkujdesjet për këta fëmijë të sëmurë, por nga ana tjetër kërkoj një transparencë, një përgjegjësi dhe llogaridhënie nga drejtorja e shërbimit social. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit ju. Zoti kryetar.

-Pjerin Ndreu: Një herë urime për zgjedhjen kryetare e Partisë Demokratike. E paske marrë me shumë entuziasëm. Ky është shërbim që shkon në shtëpi. S'ka nevojë për transport.

-Donika Ndoj: Po dhe fëmija ka ardhur tek institucioni.

-Pjerin Ndreu: Edhe fëmija ka ardhur te institucioni, pra është një histori e varet si e zgjedhin vetë. Këtu s'ka asnjë gjë për mos me qenë transparent. Këtu ka një gjë që me u shtu një shërbim ku edhe ne kontribuojmë si bashki edhe ministria kontribuon. Dhe nuk është një program, janë disa programe që po aplikohen. E kjo është një ndër gjërat që për mendimin tim nuk ka nevojë për diskutim. S'ka asgjë për t'u fshehur. E s'ka asnjë gjë për të abuzu. E s'ka asnjë gjë për t'u diskutuar. A ka gjithmonë nevojë për të bërë gjëra edhe më të mira me këta? Sigurisht që ka. Dhe normalisht që gjithmonë do ketë. Por ama ne me këto projekte të reja tregojmë se po i kushtojmë vëmendje përditë dhe me ministrinë, vetë me financimin, ne s'i kemi lënë qendrat, edhe kur na është shkëputur financimi, ne i kemi marrë vetë në dorë dhe i kemi financuar. Pra nuk kemi lënë asnjë gjë që të ngelet për financim.

-Donika Ndoj: Këto janë shqetësime që prindërit i kanë adresuar.

-Ndue Luli: Faleminderit. Ka diçka tjetër? Zonja zv/kryetare.

-Eueda Molla: Të dyja janë projekte të cilat janë në vitin e pestë që Bashkia Lezhë po i mbështet dhe tre vitet e para kanë qenë me ministrinë sipas përqindjeve sepse janë dy projekte të fituar në ministri. Dhe normalisht tani i mbështet bashkia 100%. Këto janë grante që i sjell për mbështetje.

-Ndue Luli: Faleminderit. Tjetër? Nuk ka.

Kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me 32 vota Pro. Këshilltarja Donika Ndoj votoi Kundër. Faleminderit.

Vazhdojmë me pikën 3, Projektvendim "Për miratimin e pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civilë, të punonjësve administrativë, të punonjësve mbështetës dhe të masës së shpërblimit mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave".

Në lidhje me projektvendimin, përsëri kryetari i komisionit.

-Agostin Marku: Ky është një projektvendim i shumëpritur. Ka të bëjë me pagën minimale mbi bazën e rritjes që ka bërë qeveria për pagën minimale nga 40.000 në 50.000. Janë trajtuar të gjithë pjesa e specialistëve dhe punëtorëve të shërbimeve mbështetëse. Është gjë pozitive. Janë të parashikuar në buxhet sepse ka qenë i lajmëruar me kohë nga qeveria. Edhe bashkia i ka marrë të gjitha masat që të parashikohen në buxhetin e vitit këto ndryshime. Besoj që është një motivim edhe për këtë kategori. Janë jo pak njerëz nga bashkia që përfitojnë nga ky vendim dhe përfitimet janë nga 10.000 deri në 15.000 lekë të reja për individë për kush përfshihet në këtë vendim. Ka një problem që e diskutuam edhe dje në komision. Çështja e pjesës tjetër të vendimmarrjes për

2.5% të indeksimit. Edhe për këtë, në bazë të bisedës që kemi zhvilluar me bashkinë do të pasqyrohet, por në një moment të dytë, në momentin kur ne do të bëjmë ndryshime buxhetore përsa i përket tepricave të vitit të kaluar, të cilat rekordohen në thesar dhe do vijnë në një moment të dytë, dhe atëherë me parashikimin në buxhet do bëhet edhe ky sistemim. Dhe patjetër në bazë të vendimit të qeverisë hyn në fuqi nga 1 janari. Ndaj kërkojmë që ta miratojmë pa ndryshime. Është reflektuar gjithçka e vitit të kaluar që kemi pasur me çështje specifike për menaxherë projektesh apo specialitete të tjera. Është një vendim i unifikuar. Shfuqizon të gjitha vendimet e tjera dhe siç e theksova, hyn në fuqi dhe i shtrin efektet nga 1 janari 2026. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Zonja zv/kryetare e ka fjalën.

-Brikena Vuksani: Në përgjithësi është siç e tha z. Marku, por ky vendimi i këshillit të ministrave mban datën 11.02, ku përfshin 2.5% indeksim të pagave për punonjësit e administratës, kryesisht për punonjësit nëpunësit civilë. Ndërsa për shkak të ndryshimit të pagës minimale që vendimi ka datën 15.12.2025, ne kemi parashikuar për buxhetin e vitit 2026, të miratuar në fund të vitit 2025, edhe ndryshimin për punonjësit mbështetës që janë rreth 350 punonjës që përfitojnë nga ky ndryshim. Ka një ndryshim në pagën 10.000 lekë për secilin punonjës ku përfshihen sanitare, magazinier, hidraulik, elektrikist, të gjitha llojet e shërbimeve mbështetëse në bashki. Përveç pjesës së administratës, që ne jemi duke punuar për koston financiare të këtij vendimi, meqënëse është para pak ditëve vendimi dhe ne nuk është se kishim marrë lajmërimet e duhura nga Ministria e Financave, me tepricat e vitit të kaluar dhe bashkë me ndryshimet në struktura ose me vendet vakante që do të jenë gjatë kësaj periudhe, domethënë dhjetori, janari e shkurti, do bëhen dhe ndryshimet buxhetore. Domethënë do të kemi një vendim tjetër bashkë me efektet financiare që do fillojë nga 1 janari.

-Ndue Luli: Faleminderit. Po, kush e do fjalën? Zoti Kosova.

-Soveljan Kosova: Ndryshimi në lidhje me pagën minimale ka ndonjë efekt te rejnaxhet e tjera të pagave më sipër?

-Doli këshilltari Tonin Jaku.

-Brikena Vuksani: Po, patjetër, sepse nuk është se ndryshon thjesht paga minimale. Kemi paga që sot janë mbi pagën minimale, domethënë deri në 57.000. Është të ky vendimi që janë rritur. Domethënë nëse një sanitare e kishte 41.000 lekë, sot e ka 51.000 lekë.

-Soveljan Kosova: Për pagat mbi 80.000 lekë, 70.000 lekë. Çfarë ndodh me to? Kemi ndonjë ide?

-Brikena Vuksani: Po pra, për specialistët do të jetë indeksimi i pagave, po përgatisim efektin financiar që ka ky vendim i këshillit të ministrave tek vendimi i bashkisë Lezhë, në buxhetin e bashkisë Lezhë, sepse kërkon një shtesë buxheti për pagat dhe do të vijmë me një vendim tjetër. Besoj se në fund të muajit mars, bashkë me vendimin me tepricat e vitit të kaluar, vitit 2025.

-Soveljan Kosova: Sa për informacion, ndryshimi i pagës minimale sjell ndikim te tatimi te pagat më të larta dhe ka një zbritje sipas rejnaxheve. Do ta shikoni. Zvogëlohen ca rroga që të rritet minimalja. Domethënë kjo është krejt historia e ndryshimit dhe e perceptimit të pagës minimale. Nuk ka asnjë lloj shpenzimi. Nuk ka asnjë shtesë, flas për pagat e qeverisë, të paktën

ose pagat, ndikimi i pagës minimale edhe te pjesa private ka vetëm rialokim nga një rejnxxh te një tjetër. Asnjë lek shpenzim nga shteti për këtë ndryshim nuk ka. Ka vetëm ndryshim rejnxxhesh, rritje tatimi te rejnxxhi më i lartë edhe te tjetri edhe më i lartë.

-Ndue Luli: Zoti kryetar.

-Pjerin Ndreu: Tani unë s'jam ekonomist me hy në këtë punë por kjo s'është e vertetë fare. Normalisht po u rrit rroga, rritet edhe tatimi.

Këtu ka dy probleme. E para problemi është që kur rritëm rrogat ne me VKM, që rritëm rrogat e gjithë specialistëve që janë me shërbimin civil, u ngrit një problem në këshill, pse nuk janë rritë këto të shërbimeve mbështetëse. Ja erdhën dhe u rritën. Indeksi i pagave afekton buxhetin sepse shton 18 milionë të reja, dhe duke qenë se afekton buxhetin tonë dhe ne shkojmë 18 milionë të reja, për t'i shtuar nga buxheti, ne 11 i kemi gjetë, tashti duhet me gjetë edhe 7 që të bëjmë indeksimin dhe t'i çojmë aty ku duhet. Pra nuk kemi një handicap në këtë mes dhe shqyrr që u bë ngritja e rrogave për ato shërbime që në fakt janë mbi 300 dhe bëjnë përditë punë të rënda të gjithë. Dhe ne shqyrr që erdhëm në këtë ditë. Kaq e thjeshtë është. Kurse indeksimin ne po e bëjmë, po gjejmë fondet dhe po e realizojmë. Se është çështje buxheti ajo. Janë çështje që diskutohen.

-Ndue Luli: Faleminderit. Fjalën e ka zoti Marku.

-Agostin Marku: I nderuar Soveljan.

Sa i takon kësaj çështjeje, është shumë e rëndësishme të sqarojmë se kjo shtresë e cila përfiton nga ky vendim nuk ka asnjë sanksion në çështje taksa, tatime, sigurime, e tjera, e tjera. Madje qeveria ka marrë masa edhe për subjektet private që diferencën nga 40.000 deri në 50.000 për sa i përket kontributeve ta paguajë prapë shteti, ta subvencionojë shteti. Dhe konkretisht është ngarkuar Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive ta kryejë këtë veprim. Sa i takon çështjes se me rritjen e pagave do rritet edhe kufiri, po do rritet, por rritet tek pagat e larta kufiri, po dhe ky kufi ka një tavan si për sigurimet, si për tatimet e për gjithçka tjetër që e dinë mjaft mirë specialistët e financës që janë këtu. Tani, kur nuk ishin rritë pagat, thamë t'i rrisim, t'i rrisim edhe pse s'ka vendim qeverie. Kur vjen vendimi i qeverisë, themi jo po ka me ndiku kështu, ashtu. Këto janë pa ndikim fare. Shqyrr që janë rritë e urojmë që të rriten vit pas viti. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Zonja Ndoj.

-Donika Ndoj: Punonjës të mirëpaguar, normal që janë më të motivuar për të punuar më mirë dhe më pas për të na përcjellë një shërbim cilësor. Për sa i përket punonjësve teknikë, në fakt te kjo fleta numër tre shoh që në tre vende thotë shofer-shofer-shofer. Dhe patjetër për shoferë administrate bëhet fjalë por me tre paga të ndryshme. Punonjësit teknikë në fakt meritojnë vlerësim real, kur flasim për mekanik, agronom, hidraulik, bojaxhi, etj., për të cilët mendoj që duhet të ketë një plan për një rritje graduale të këtyre profesioneve pasi kërkojnë paga dinjitoze bazuar në meritë, përgjegjësi dhe drejtësi buxhetore. Për sa i përket punonjësve të administratës, dua të theksoj edhe diçka, sepse në administratë mund të ketë edhe punëtorë, punonjës të cilët kanë mbushur moshën e pensionit dhe akoma vazhdojnë që të jenë në punë dhe të paguhet në administratë, apo mund të ketë edhe punonjës fiktivë të cilët mund edhe mos të marrin pagat dhe mos të shërbejnë. Patjetër që për moshën kjo duhet të vërehet, sepse kërkojmë që sa më shumë

punëtorë të rinj, sa më shumë punëtorë të cilët kanë me mbajtur familjet e tyre, që t'u hapet rrugë edhe që të jenë në punë. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Zoti Kryetar.

-Pjerin Ndreu: Shoferët s'mund të jenë njëlloj, se janë në drejtori e sektorë të ndryshëm. Sepse ka shoferë, për shembull, të makinave ekologjike, që i kemi futur në tashti, që është tjetër gjë. Ka shoferë të shërbimeve, që është tjetër gjë. Ka shoferë të njësisë, që është tjetër gjë. E para.

E dyta, ka persona që kanë dalë në pension për ne i kemi mbajtur. Kemi mbajtur muratorë për shkak se nuk na vinin muratorë. Kemi specialistë tamam të kësaj pune. Na është dashur me mbajtur një shërbim tjetër që nuk e gjejmë. Punëtorë gjejmë, po nuk gjejmë specialistë. Ka specialitete që ne nuk i gjejmë, jemi detyru që t'i shtyjmë pensionin.

E treta, unë nuk di qysh prej kohësh, ka qëllu njëherë në një njësi që ishin tre punëtorë që nuk shkonin në punë e janë shkarkuar të nesërmen në vend. Që mund të jetë ndonjë, po që ne ta kemi fenomen që mos të vijë në punë e të marrë rrogën, unë s'e di. O ne e kemi shtrënguar këtë punë, o s'ka, kemi gjetë nja 600 që s'vinin fare. Po unë mendoj se o kemi bërë punë në këtë histori, ne jemi ballëhapur para opinionit publik, se nuk japim rroga tu nejt në shtëpi, pastaj se ç'a bëjnë punë, është tjetër gjë, a e bëjnë tamam si duhet, a s'e bëjnë si duhet, kjo ngelet për t'u pa në përditshmëri. Ka zero tolerancë, kushdo që mendon se në Bashkinë Lezhë mund të marrë rrogën te nejt te shpia. S'ka shans. Unë nuk e di nga e nxjerrin këtë konkluzion, këto janë ca tymçe që nuk është mirë me i hedhë.

-Ndue Luli: Faleminderit. Tjetër mendim? Zoti Ndreca.

-Erin Ndreca: Përshëndetje të gjithëve. Mendoj që për projektvendimin në fjalë, ne duhet të përgëzojmë vendimin e qeverisë për rritjen e pagave minimale. Nuk është në kuadrin tonë, mendoj, që të bëjmë politikën e madhe për të dalë jashtë kompetencave si organ vendor. Dhe nuk mendoj që për arsye të ndryshme kemi arsye të hedhim baltë mbi një vendim i cili është shumë i duhur dhe shumë i nevojshëm për të mbështetur ato shtresa të cilat prek ky vendim. Prandaj, hedhja e të gjithë hipotezave të tjera më duket e pavend. Sepse janë të gjitha hipoteza, ngelen në kuadrin e hipotezave. As unë nuk jam specialist në këtë fushë, por e thënë ndryshe, nuk kam parë, lexuar apo dëgjuar që rritja e pagës minimale i ka ulur pagën dikujt tjetër, me sa e kam kuptuar unë. Dhe e kalojmë pastaj nga një vendim ligjor, në hipoteza të cilat janë të diskutuara dhe të stërdiskutuara, dhe nëse ka një meritë, bashkia e ka pikërisht tek menaxhimi i punonjësve, që siç e dimë shumë mirë sa ka qenë numri i punonjësve që s'vinin fare dhe sa është sot numri i punonjësve të cilët në çdo moment janë të pranishëm në vendet e tyre të punës. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Atëherë, kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me 31 vota Pro. Këshilltarja Donika Ndoj votoi Abstenim. Faleminderit.

Kalojmë te pika 4, Projektvendim "Për miratimin e Raportit për Vlerësimet dhe Parashikimet Afatmesme të të Ardhurave për Programin Buxhetor Afatmesëm 2027-2029".

Përsëri, fjalën e ka kryetari i komisionit të financës.

-Agostin Marku: Është një projektvendim që përgatitet në kuadrin e të gjithë vendimmarrjes për projektbuxhetin afatmesëm. Pozitiv është fakti që rritja nga viti në vit është shumë e lehtë, madje kjo rritje përfundon në 2027, nga 2027 e më tej rritja vjen gjithnjë edhe më e ulët, çka flet për konsolidim në drejtim të taksave dhe tarifave vendore në bashkinë e Lezhës dhe mirëmenaxhim, duke rritë cilësinë e shërbimeve, por duke mbajtur në nivel edhe detyrimet që kanë familjet, bizneset e tjera për të paguar për shërbimet që marrin. Ndaj, ju propozoj që ta miratojmë pa ndryshime. Faleminderit.

-Ndue Luli: Kush ka mendim tjetër? Zonja Ndoj.

-Donika Ndoj: Atëherë, flasim pak për një projektvendim që na parashikon të ardhurat për 2027-2029, që janë parashikime optimiste të të ardhurave. Ajo çfarë vërej nga tabela është, sepse flasim të ardhura faktike nga 2024-2025, po ta krahasojmë me 2026, normal që ka një diferencë shumë të madhe, 2025 me 2026. Ajo çfarë dua të them, a janë reale këto parashikime, apo ndoshta kemi bërë parashikime pak të fryra. Kur flasim për peshën kryesore që merren nga të ardhurat tatimore 68-69%, këto të ardhura pikërisht a rëndojnë mbi bizneset edhe qytetarët? Taksa e ndikimit në infrastrukturë 47% 2026-2027-2028, besoj që rëndon pak, është një barrë fiskale mbi bizneset e vogla edhe të mesme, sepse ndodh që ka biznese të cilat nuk arrijnë që të likuoidjnë detyrimet e tyre. **(Ka ndërhyrje pa mikrofon)**

Në lidhje me projektbuxhetin, përsa i përket bizneseve, nga ana tjetër, drejtoria e taksave dhe tarifave vendore na del edhe na thotë që njofton për biznese të cilat nuk kanë likuiduar detyrimet që duhet t'i likuoidjnë, apo do të hiqen gjobat, edhe gjobat që do t'u vendosen atyre, ndërkohë që nga ana tjetër tregon se bizneset nuk kanë arritë me i likuidu 2020-2024, nuk kanë arritë që të likuoidjnë detyrimet. Atëherë, okej, atëherë çfarë mund të bëjmë për këta biznese të cilat nuk kanë likuidu, po sot a janë në vështirësi financiare disa biznese, biznese të vogla dhe biznese të ulëta? Nga ana tjetër, shpopullimi tregon më pak konsum, më pak shërbime, më pak të ardhura, ndërkohë që ju parashikimet janë optimale, shumë të larta. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Zoti Kryetar.

-Pjerin Ndreu: E para e punës vitet 2020-2021 kanë qenë vite pandemike.

E dyta, që s'kanë krahasim, domethënë, në kuptimin e të ardhurave, kanë qenë vite ku gjithë Shqipëria, e bota, biznesi ka qenë në nivelet më të ulta të mundshme dhe ne vetë këtu kemi qenë dhe i kemi siguruar bizneset, duke mos i vënë presion, s'mund ta marrësh si referencë.

Tjetër, 2022-2023, filloi lufta dhe janë rritë çmimet në treg dhe ka krijuar një kolaps tjetër në botën e biznesit për shkak të taksave dhe ne kemi kalu normalisht në situata të vështira, përsa i thonë kësaj. Nuk ka një buxhet që, në qoftë se ma gjeni ju, një buxhet që i realizon të ardhurat 100%, kjo s'ka ndodhur, as shpenzimet. Me të ardhurat afektohen edhe gjithë punët që bëjmë ne, bëhen me zbritje dhe duke qenë se bëhen me zbritje, në qoftë se ne për shembull planizojmë një prokurim me 500 milionë, kur të prokurohet, ajo shkon në 350, 450, 500, varet si t'i bie, pra. Shkon gjithmonë me ulje dhe shpenzimet nuk shkojnë në atë nivel me atë që mendojmë ne dhe kursehen lekë, edhe reflektohen pastaj te tepricat. Ose ka të kontrata, që lidhen në qershor dhe në vitin buxhetor nuk realizohen, sepse kështu ka ardhur rotacioni i këtyre dhe na afektojnë. Për shembull, kemi kontrata ne, për 2025, që nuk i kemi realizu, por i kemi në proces. Pra, janë gjëra që nuk kanë ardhur për efekt të mospagesës. Ne kemi kaluar vitin 2025 më 31 janar, me gati 3

miliardë në arkë. Pra, hera e parë në histori që ne shkojmë në këtë kuotë. Nuk është se nuk i kemi lekët aty, problemi është se kontratat kanë kohën e vetë, kanë ngecjet e veta, kanë përfundimet e veta që ne nuk na lënë që brenda një viti të kornizuar buxhetor, ne ta bëjmë 100%. Pra, shkon duke u vënë nëpër vend edhe gjatë vitit që vjen. Dhe kjo ndodh kudo. Nuk është këtu, në qeveri, në cilindo shtet të botës ndodh kjo.

Taksa e ndikimit në infrastrukturë është një problematikë që lidhet me lejet e ndërtimit. Lejet e ndërtimit, normalisht janë një burim i jashtëzakonshëm i të ardhurave, për shkak se Bashkia e Lezhës është bashki me shumë shërbime, nuk është me pak shërbime, dhe mos harro se, tre deri në katër muaj në sezonin veror, ne na dy dhe trefishohet popullata, mos më shumë madje, dhe normalisht rriten shpenzimet dhe shpenzimet që bëjmë ne për mirëmbajtje, për pastrime etj rriten. Normalisht, duke pasur edhe shpenzime, ne na duhen lekë, edhe rritja e rrogave që na ka impaktuar disa herë, edhe investimet që janë rritur në mënyrë të ndjeshme, pra kanë impaktuar gjithmonë të ardhurat e bashkisë, ku taksa e infrastrukturës, në fakt është një e ardhur të cilën ne po e shikojmë me kujdes. Unë mendoj se sivjet ne do shkojmë shumë më lart se sa taksa e infrastrukturës që kemi planizuar. Jo mendoj, por besoj, sepse vetëm në AZHT, tani janë të paktën 7-8 leje ndërtimi në prag të daljes së lejeve dhe ne nuk kemi pse mos të jemi optimistë, sepse të ardhurat do jenë në nivele të ndryshme. Tani për sa i përket bizneseve, janë me statistikë, të paktën mbi 500 biznese në vit rriten. Do ju kërkoj përfaqësuesve të opozitës të flasin me terma zyrtarë, jo me terma hamendësimi. 500 biznese në vit shtohen. Disa pakësohen, sa ngelin, por gjithsesi janë shumë me rritje, jo me ulje. Pra, ka biznese në vështirësi, po sigurisht që mund të ketë, por për shkak edhe të menaxhimit të vet, të problematikës, të zgjedhjes së mënyrës se si bëjnë biznes, përkushtimit që kanë në biznes, ka plot raste kur nuk shkojnë, po jo se ne i kemi mbytur me ndonjë taksë. Dhe biznesi i vogël s'ka taksa. S'ke pse e përmend fare. Ose marrëdhënia e pushtetit lokal me biznesin ka qenë e sforcuar, s'ka shans. Përkundrazi. Ne nuk kemi absolutisht as edhe një përplasje me biznesin, as edhe një, nuk ka ndodhur që ne të përplasemi apo të kemi një reagim të biznesit për shkak të politikës tonë të gabuar apo mënyrës së sjelljes tonë të gabuar. Edhe kur ka pasur ndonjë sekuençë ku diku nuk llogaritet mirë diçka, ne kemi ndërhyrë dhe e kemi përmirësuar, por kjo nuk duhet marrë si alibi, me thënë se s'bëjnë këta. Në aspektin e sjelljes së përgjithshme, mënyrës së komunikimit, bashkëpunimit, për mua është në nivele jashtëzakonisht të mira, që te unë i pari e deri të punonjësi më i thjeshtë i taksave të cilët janë në kontakt të vazhdueshëm me bizneset për gjithçka që duan, duke dhënë akses edhe online, duke dhënë akses edhe drejtpërdrejt, duke iu vënë dispozicion për gjithçka.

-Ndue Luli: Faleminderit. Zonja Marku.

-Alfrida Marku: I them dy fjalë se në fakt më herët e kemi diskutuar shumë këtë çështjen e detyrimeve vendore dhe personalisht me aq angazhim sa kam pasur në atë institucion, unë vlerësoj se analiza në drejtim të të ardhurave vendore nga ne si këshilltarë bashkiakë duhet shtrur në dy elemente. Sa janë të ardhurat që planifikohen edhe se si ofrohet shërbimi në vijim nga institucioni përgjegjës, në këtë rast Bashkia Lezhë. Dhe nëse kemi rritje të të ardhurave, pyetja dhe mbikëqyrja nga ana e këshilltarëve bashkiakë, duhet të fokusohet se a është kjo rritje pasojë e përmirësimit të këtyre shërbimeve përkatëse. Sa i përket taksës së ndikimit në infrastrukturë, personalisht jam optimiste nëse rritja në total e parashikimeve të të ardhurave vendore vjen pikërisht nga rritja e këtij zëri të të ardhurave, sepse kjo përkthehet në ndërtime të reja, kjo përkthehet ndryshe në një fokus të përmirësuar të Lezhës sa i përket zhvillimit të turizmit. Ju e thatë që rritja e ndërtimeve sjell edhe të ardhura të jashtëzakonshme sa i përket taksës së ndikimit

në infrastrukturë dhe unë do të shtoj këtu që sjell edhe përgjegjësi të mëdha dhe afatgjata ndaj institucioneve përgjegjëse që pikërisht këto detyrime të shkojnë ekzaktësisht në vendosjen, mirëmbajtjen e përhershme të kësaj infrastrukture në shërbim të këtyre ndërtimeve të reja që janë në proces dhe do të jenë. Personalisht ndaj mendimin që, duke parë edhe zhvillimin e Lezhës në aspektin turistik, unë mendoj që pse jo, ne si këshill bashkiak duhet të marrim edhe një nisëm për rritjen e taksës së ndikimit në infrastrukturë për objektet, sidomos në zonën turistike, sepse sikurse edhe e përmenda, taksa nga subjektet ndërtuese paguhet sot, ama përgjegjësia e institucionit për të vendosur rishtas infrastrukturën dhe për ta mirëmbajtur ndër vite është afatgjatë dhe e përhershme. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Zoti Kryetar.

-Pjerin Ndreu: Rritjen e buxhetit nuk është taksa e infrastrukturës që megjithëse mban një peshë, sidomos vitin që kaloi dhe sivjet, por që nuk është realizu sa duhet për shkak të procedurave që dihet që janë atje pak të vështira. Por është rritë performanca e strukturës së drejtorisë së taksave në mënyrë të ndjeshme, marrëdhënia me biznesin, qartësia se vetëm po të marrim taksën e fjetjes, ku ishte, ku është, është një ndryshim. Dhe po të marrim taksën e hapësirave publike, është një ndryshim. Pra, të gjitha kanë ndryshu totalisht. Përsa i përket taksës së infrastrukturës, ne pretendojmë që lejet që dalin tani dhe ato që kanë dalë, asnjë ndërtim më në Shëngjin, as në bregdet nuk lejohet pa qenë një arkitekt, në studiot më të mira në Europë, deri në Japoni, ke struktura tani japonezë, anglezë, austriakë, italianë. Pra, nuk ka asnjë projekt që bëhet nga arkitektë shqiptarë. Që do të thotë që ka një shpresë tjetër për të shpëtuar ato që kemi për të shpëtuar. Në kuptimin e referencës të asaj që thoni ju me të drejtë, në fakt, që duhet të rritet taksa, nuk kemi nevojë me rritë taksa, se shteti ka referenca, referencat do rriten në mënyrë të ndjeshme në gjithë bregdetin për arsye të çmimeve që kanë kërcyer në mënyrë marramendëse për arsye të tregut. Ka treg, ka projekte të bukura. Dhe është kërkesë e ne kryetarëve të bashkive, në qeveri që ne s'mund të shkojmë me referencë. Ka një përllogaritje, ka një ngecje sepse ka një përllogaritje shumë të gabuar në disa struktura qeveritare, ku unë i pari kam reaguar bashkë me disa kryetarë bashkish që barazon për shembull Ungrejn me Talen. Kjo është absurde. Ne kemi ndërhyrë, dhe po vihen nëpër vend, ajo do reflektohet, mos ki merak, do paguajnë shumë më tepër sesa paguajnë sot. Dhe kjo është po një garanci tjetër për të marrë lekë dhe për të pasur financa më të shëndosha në të ardhmen.

-Ndue Luli: Faleminderit. Atëherë, kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me 29 vota Pro. Këshilltarja Donika Ndoj votoi Abstenim. Këshilltarët Soveljan Kosova dhe Emanuel Perjaku nuk votuan. Faleminderit.

Vazhdojmë me pikën 5, Projektvendim "Për miratimin e prioriteteve dhe projekteve për investime në kuadër të përgatitjes së PBA-së 2027-2029 dhe të buxhetit të vitit 2027".

Për këtë fjalën e ka përsëri kryetari i komisionit të financës.

-Agostin Marku: Është një projektvendim si ai që sapo miratuam në kuadrin e përgatitjes së projektbuxhetit afatmesëm 2027-2029. Janë specifikuar të gjitha fushat dhe prioritetet që ka bashkia. Në mbledhjen e dy komisioneve doli si detyrë për drejtorinë e shërbimeve që të na sjellë të specifikuara edhe rrugët, me sa kam informacion unë i ka sjellë, po dje, dhe janë shpërndarë, por tek lidhja një duhet të pasqyrohen të gjitha. Pra, këto ndryshime duhet të pasqyrohen kur të zbardhet vendimi. Dhe me këtë mendojmë që duhet të miratuar. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Zoti Kosova.

-Soveljan Kosova: Atëherë te prioritetet për tre vitet e ardhshme, shohim ca investime duke filluar nga 2027, të shkollave në vlerë 1.4 milionë euro, një shkollë 9-vjeçare, të cilës nuk është se mund t'ia di fiks perspektivën realisht, por ka shumë arsye për të ngritë pikëpyetje për shumën e lekëve që shpenzohen aty. Një shkollë 9-vjeçare me 100 fëmijë, sipas informacioneve nuk e dimë nëse është e vërtetë, ekzakt të harxhohen 1 milion e gjysmë euro në shkollë fshati, është një investim për mendimin tim, jo në vendin e duhur. Nuk e di, 1 milion e gjysmë euro do të thotë 3000 metra katrorë ndërtim, sipas çmimeve të referencës së një kolegu tim këtu. Kështu që besoj se duhet të shpenzoheshin diku ku efekti mund të ishte shumë më i madh. Një çerdhe e planifikuar në 2029 me një vlerë 2 miliardë lekë. Nuk e di se sa të justifikueshme janë këto parashikime për investime, por besoj se edhe vendet më të mira në Evropë do na i kishin zili.

-Doli këshilltari Ervin Coli.

-Ndue Luli: Faleminderit. Zoti Kryetar.

-Pjerin Ndreu: Që të jemi të qartë, se unë vihem në dijeni dhe për debatet që bëni ju nëpër komisione, për hamendësimet dhe për gjërat. Këto janë projekte të UNICEF që i kanë hartuar ata. Dhe shkolla nuk ka të bëjë me metër kator për godinë, mos e bëj atë gabim se je dhe ekonomist. Ka të bëjë dhe me terrene sportive, me gjithçka, i kanë llogaritë ata me standardet e veta. Normalisht, ne na intereson, por kjo shumë nuk mund të bëhet me buxhetin e bashkisë. Kjo aplikohet, sikur kemi aplikuar shkolla të tjera, aplikohet dhe i merr qeveria në dorë dhe ne nuk është se kemi ndonjë fryrje këtu se s'kemi bërë ne projekte. Pra, që të jemi të qartë, pra nuk është se ne, se këtu domethënë gjithmonë ka diçka mbrapa që ne kemi bërë, se këtu kemi shkruar shumë, se kjo shumë s'është e jona fare. E kanë bërë për komunitetin, na kanë ofruar disa projekte me këto që janë këtu, janë të natyrshme. Ka edhe infrastrukturë rreth e rreth shkollës. Kanë tjetër perceptim për gjënë ata. Tani, ne, edhe në qoftë se, ajo është më e shtrenjtë dhe me terren e të tjera, ne kemi dhe një klauzolë që shkollat janë edhe qendra komunitare ku mund të përdoren edhe për gjëra të tjera, ose mund të akomodohet edhe një kopsht aty, ose një çerdhe, ose gjëra që ne pastaj na shërbejnë edhe për aktivitete të tjera. Kjo nuk do të thotë që pse është bërë kaq shumë dhe nuk duhet të bëhet. Në procesin e prokurimit pastaj ka edhe ulje, se zakonisht nuk shkojnë kaq sa i nxjerrin shumat. Po ata e kanë përlllogaritë, që të jemi të qartë se s'është përlllogaritja jonë, që i nxorëm ne, i vumë aty dhe këta do të kenë bërë një gjë korruptive se e kanë përlllogaritë shumë, e kanë bërë pak. Është projekt UNICEF dhe është me konceptin e atyre.

-Soveljan Kosova: A mund të përdoret diku tjetër me më shumë efekt?

-Pjerin Ndreu: Tani, këto janë në kuadrin e projekteve dhe parashikimeve. Nesër ne mund të gjykojmë që disa elementë, disa parashikime të tyre janë të panevojshme dhe ne nuk i bëjmë, i kemi në dorë vetë. Këto janë parashikime që na janë dhënë sipas një koncepti që ata e kanë përpunuar dhe kaq.

-Ndue Luli: Zonja Marku e ka fjalën.

-Alfrida Marku: Faleminderit. Duke i lexuar një për një, padiskutim që secili investim i parashikuar përbën një zgjidhje të një problematike konkrete. Por nëse diskutohen në planin e prioriteteve, sikurse kam shprehur përherë, por sidomos në ato mbledhje kur diskutohet buxheti vjetor, gjithmonë duhet të kemi parasysh se sapo flasim për bashkinë Lezhë, kur projektojmë dhe planifikojmë investime, patjetër që duhet të kemi parasysh që këto investime duhet të shtrihen në mënyrë të drejtë dhe të arsyeshme në secilën njësi administrative. Pasi në fund të fundit, të gjithë banorët kanë të drejtë që, sikurse janë taksapagues, të marrin edhe shërbime të përmirësuara dhe investime të reja në zonat e tyre. Patjetër, duke shtuar faktin që një buxhet nuk zgjidh çdo problematikë, por hap pas hapi shkojmë drejt zgjidhjes. Pse e them këtë? Nuk më vjen mirë që edhe në parashikimet buxhetore për 2027-2028-2029, sërish njësi administrative e Balldrenit nuk më rezulton me ndonjë investim të parashikuar, pavarësisht se unë ndërkohë që flasim, ne kemi edhe 10 muaj që ta rishikojmë këtë planifikim dhe unë shpresoj që në fazat e tjera të diskutimeve, kur të vijmë tek buxheti, bashkia Lezhë për 2027 dhe vijim ta përfshijë edhe njësinë administrative të Balldrenit me investime konkrete. Unë mendoj që në listën e prioriteteve të bashkisë Lezhë duhej përfshirë edhe ndërtimi i objektit të ri në dispozicion të qendrës së zhvillimit ditor. Pse e them këtë? Dihet tashmë që një objekt, një ndërtesë e re bën të mundur shërbime më të mira cilësore për individët që marrin shërbim në këtë qendër, por patjetër edhe kushte më të mira, lehtësi pune dhe për stafin që ofron këto shërbime. E vlerësoj jashtëzakonisht faktin që në 2027, në prioritetet e bashkisë Lezhë, është ndërtimi i çerdhes së qytetit të Lezhës, është një investim që pritej prej shumë kohësh. Ky projekt, sikurse u sqarua dje në mbledhjen e komisioneve do të zgjidhë çështjen e akomodimit apo do të ketë një kapacitet për të pritur rreth 150 fëmijë që do të marrin shërbimin në çerdhen e qytetit të Lezhës. Pyetja ime është nëse në këtë investim, pra që ju do të rikonstruktioni dhe do të përshtasni godinën e vjetër të shkollës "Kosova", në këtë investim, në këtë projekt, a parashikohet edhe sistemimi i hapësirave të jashtme, me qëllim që fëmijët të realizojnë aktivitetet edhe jashtë godinës së çerdhes?

Ndërkohë, mendoj se për 2027 duhej që të ishte në prioritetet e adresuara nga bashkia Lezhë edhe ndërtimi i çerdhes dhe kopshtit në qytetin e Shëngjinit, sikurse edhe në mbledhjet e mëparshme edhe nga ana e zonjës Sokolaj, por është shprehur edhe nga këshilltarë të tjerë, është shprehur si domosdoshmëri për këtë zonë dhe si problematikë për prindërit që në fund të fundit duan të punojnë, por s'kanë ku të çojnë fëmijët në çerdhe dhe kopsht për shkak të kapacitetit jo të duhur. Ku e shoh zgjidhjen? Sepse shpesh herë në mbledhje ju arsyetoni që po mirë cilin projekt të heqim që ta zëvendësojmë me këtë tjetrin. Keni parashikuar një fond prej 2 miliardë lekë për ndërtimin e çerdhes në Shënkoll. Absolutisht i duhur, i domosdoshëm, por a është më e arsyeshme që ky fond të rishikohet? Dhe pse jo, gjysma e këtij fondi t'i akordohet ndërtimit të çerdhes dhe kopshtit në Shëngjin, gjysma e këtij fondi ndërtimit të çerdhes dhe kopshtit në Shënkoll, duke pasur parasysh edhe kapacitetet e pritshme ose numrin e fëmijëve që presin të marrin shërbim në këto institucione. Sa i përket njësisë së Balldrenit, për fshatin Balldren, mendoj që duhet të parashikohet kopsht dhe çerdhe për fëmijët, duke iu referu kërkesave. Dhe unë kam një propozim, nuk është nevoja që të ndërtojmë nga e para, por godinën e mbyllur, jo të vjetër, ajo është rikonstruktuar vitet e fundit, godinën e mbyllur të shkollës fillore në fshatin Balldren i Vjetër, pse jo, ta përshtasim në çerdhe apo kopsht sipas kërkesave. Sa i përket shkollës së Troshanit, unë sugjeroj që kur diskutohet për investim në arsim, duhet t'i inkurajojmë. Edhe unë këtu dua të shtoj një element. Zona e Zadrimës tashmë është kryer në udhëheqës të agroturizmit, pra është një ndër pikat më të forta të Lezhës sa i përket agroturizmit. Edhe kthimi i asaj shkolle edhe në një qendër komunitare është ndihmë shumë e madhe për prindërit e asaj

zone që të angazhohen në bujqësi dhe në biznese të agroturizmit, ndërkohë që fëmijët akomodohen dhe marrin shërbimin në këtë shkollë edhe përtej orarit 5 apo 6 orë në ditë. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Zoti Kryetar.

-Pjerin Ndreu: Unë jam dakort me shqetësimet, por jo me viktimizimin që mundohesh me i bë Balldrenit. S'ka asnjë lloj viktimizimi Balldreni, përkundrazi. Sot që flasim, Torovica është transformu, me rrugët, me linjat elektrike që kemi ndërhyrë në ndërmjetës, me rikualifikime, me kanale kulluese, s'ka ngelur gjë pa u hapë atje. Jemi në prag të marrjes edhe të hidrovorit, që ta dish. Në Gocaj, në Kakarriq, kemi një ujësjellës që po bëhet. Dhe normalisht që nuk mund të ndërhyhet në infrastrukturë pa mbaruar punë firma aty. Në Kodër Balldren janë bërë të gjitha, s'ka ngelur gjë. Nuk janë bërë 10 rrugë së fundmi. Edhe në Balldren Poshtë kemi bërë, por kemi një problem në Balldren Poshtë, sepse në gjurmën e rrugës së Milot Balldrenit dhe në lidhjen që do të jetë nga Balldreni në Muriqan, jemi në diskutime se aty do të bëhet nyja e lidhjes së rrugëve. Dhe ne nuk kemi të qartë se ku lidhemi e sa do shpenzojmë e si do të dilet nga autostrada tek rruga X, e si do të hyhet këtej. Pra, kemi një problem paqartësie që lidhet për shkak të atij projekti shumë të madh që është në diskutim sot. Dhe diskutimi më i nxehtë ka qenë problemi i depos së ujit, diçka e tillë, ku KFV nuk pranon me e spostu, këta duan me e spostu. Pra, nuk është se Balldreni ka ngelur jashtë, është në fokus sot që po flasim, po punohet atje. E kam thënë, së shpejti në Balldren Fushë do hapen kanale kulluese që janë në krahun e djathtë të rrugës. Pra, nuk është një gjë që ne kemi lënë pa bërë. Dhe e dyta, në Balldren, ne kemi lënë një fazë të dytë duke gjykuar mbi këta, ndoshta firma ne në Goaj-Kakarriq na hap krahun dhe ne hyjmë me rrugë. Në 2027 kemi 6.9 miliardë rrugë të planizuara, sikur asnjë gjë mos të ndodhë, Balldreni do të ketë peshën e parë, sepse sivjet, tani që i kemi miratuar këtu në këshill ne, përveç rrugëve që bën qeveria, që janë 57 rrugë që bën vetëm në njësinë Shënkoll edhe në dy ishujt, bën qeveria, kemi rënë dakord me ta, me Fondin Shqiptar të Zhvillimit, për shkak të turizmit, janë dhe 69 rrugë të tjera rurale që bëhen, janë edhe 43 rrugë në qytet, janë 169 rrugë që bëhen në Lezhë. Nuk ka parë historia e zhvillimit ndonjëherë kaq numër të madh investimesh. Pra, nuk është se e kemi lënë, por po të marrim Mërqi-Rraboshtën. S'kemi si të hyjmë aty, të bëjmë rrugë në një vend ku po punohet. Shëngjinin unë e kam shqetësim. Çfarë shqetësimi ka Shëngjini sot? Dhe flas me këmbë në tokë, se këto janë dakord për kopshtin që ne do të rrisim kapacitetet. Jam shumë dakord, 2 miliardë me thënë të drejtën, më duket pak si i fryrë, por mund ta ndajmë një me një, me Shëngjinin ose me Balldrenin.

Shëngjini ka një problem që ne po bëjmë projektin. Ne duhet të ndërhyjmë patjetër në sistemin e kanalizimeve të ujërave të bardha për shkak se mban ujë Shëngjini. Po ta shikosh sot, ne jemi duke bërë një studim total të Shëngjinit se si ta nxjerrim nga uji. S'ka ku shkarkon. Dhe ne kemi thirrë ekspertë dhe po bëjmë projektin që ne duhet të ndërhyjmë fiks fare aty. Së dyti, jemi në diskutim me KFV-në që të hyjmë në sistemin e shpërndarjes së ujësjellësit atje. Sepse ne kemi rritë kapacitetet vjet, kemi normalizuar këto problematika që s'ka ujë, s'ka ujë, por sistemi i shpërndarjes me ndërtime e reja që supozohet që do bëhen, do na krijojë prapë probleme në furnizim në disa zona dhe ne duhet t'i dalim përpara kësaj me një projekt. Çka do të thotë që ne jemi duke e parë procesin, Ne do të hyjmë sesbën me një proces të organizuar. Edhe po ju jap edhe një bisedë, s'është sekret, me kryeministrin, kur isha në Abu Dabi, i, thashë: "Gjej ndonjë arkitekt të huaj edhe ta fusim Shëngjinin në një koncept zhvillimi edhe transformimi, se nuk është shumë, tamam bashkëkohor me standard shumë të lartë." Më pëlqen-tha- si ide dhe mund

ta bëjmë. Unë kam ide më të avancuara, sa jemi të zot me e bë pastaj, ngelet për t'u parë. Një e kam thirrë dhe do na bëjë konceptin e bashkisë së re, do gjejmë vendin.

Për Milot-Balldrenin është mbyllur procedura, pritet shpallja.

Ne do ndërhyjmë me një proces tjetër tani që qyteti ta marrë komplet dozën, jemi duke e studiuar edhe bashkë me drejtorin e urbanistikës dhe një grup arkitektësh.

-Ndue Luli: Mirë, atëherë kush është dakord me projektvendimin duke i shtuar vendimit edhe të lidhja një, listën e rrugëve të detajuara, e cila është paraqitur, është kërkuar nga komisioni dje. Miratohet me 27 vota Pro. Këshilltarët Soveljan Kosova, Emanuel Perjaku, Donika Ndoj votuan Kundër, 3 vota Kundër. Këshilltarja Alfrida Marku abstenoj.

Vazhdojmë me pikën 6, Projekt-Vendim "Për dhënien në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor kombëtar, shoqërisë One Albania sha, për antenat e telefonisë celulare, fshati Balldre, Njësia Administrative Balldre dhe fshati Mabë, Njësia Administrative Dajç, Bashkia Lezhë" Fjalën e ka zoti Marku.

-Agostin Marku: Edhe këtë projektvendim e pamë dje së bashku, komisioni i financës dhe komisioni i bujqësisë. Duhet të sqaroj që në fillim, nuk është votuar kundër, nuk është realizuar kuorumi sepse do shumicë të cilësuar.

Ky është një projektvendim që duhet miratuar. Ka një problem që është ngritur në komision por edhe në mbledhjen e kaluar të këshillit, çështja e rrezatimit, problem të cilin drejtorja e bujqësisë e shpjegon se është një leje mjedisore nga organet kompetente, pra lejen mjedisore nuk e jep bashkia, nuk e jep këshilli i bashkisë, por e japin organe të tjera. Mbi bazën e asaj veprohet. Kur ka ndonjë diçka, ndonjë indicie, edhe mund të verifikohen, ngrihen komisione, por ne nuk mund të rrimë peng i vendimmarrjes edhe të vazhdojmë të qëndrojmë ashtu sikur rrimë me kontratat e viteve para 2015 për të gjithë rastet e kësaj natyre. Madje dje në mbledhje të komisionit kemi dalë me një konkluzion që t'i kërkohe bashkisë që të bëjë një studim të hollësishëm për gjithë territorin e bashkisë dhe sidomos për zonat urbane, zonat e populluara, në fushën e çështjes së këtyre kompanive që përdorin antena dhe të shikohet mirë çështja e rrezatimit, sa ndikon te këto zonat urbane, të merren masat e duhura, dalim me një vendim të arsyetuar edhe për këto raste dhe kur ka raste të tilla t'i heqim, t'i largojmë. Pikë së pari kemi shëndetin e njerëzve, pastaj të tjerat, por edhe të lidhim kontratat me të gjithë pa përjashtim me atë tarifë që vendoset për qira që të kemi edhe të ardhura nga kjo fushë aty ku lejohet, aty ku e lejon ligji, aty ku realizohen të gjithë ato kriteret për lejet mjedisore. Pra, në parim, ne duhet ta kalojmë këtë dhe duke i kërkuar bashkisë atë që të bëjë një studim të hollësishëm për gjithë territorin e bashkisë. Faleminderit.

-Ndue Luli: Po, zoti kryetar?

-Pjerin Ndreu: Sa i përket kësaj, është kriju ideja sikur ne e kemi hall të madh atë punë.

E para, ata nuk paguajnë asnjë lek, s'ka asnjë kontratë fare. Janë aty në terezinë e vet dhe askush s'është marrë fare me atë histori.

E dyta, është një shërbim që i jepet komunitetit. Ne s'kemi absolutisht as edhe një hall tjetër në këtë lloj historie, që mos t'i shkojë mendja kujt se po i bëjmë ndonjë shërbim ONE-it. Është një shërbim që impakton komunitetin atje për shkak të telefonisë. S'doni ta bëjmë? Po. Ua heq antenën nesër në mëngjes. S'kemi asnjë lloj emocioni. Për sa i përket pastaj pozicionimit të

antenave në qytet dhe atje ku ka, hajde të thërrasim ekspertët çfarë problemi ka. T'na japin një vlerësim të gjithë antenave ku janë vendosur, sa impaktojnë shëndetin e njerëzve, sa s'impaktojnë, sa bëjnë, sa s'bëjnë, ky është një diskutim shumë i madh dhe duhet adresuar. Por që të themi ne jo, mos t'ia japim këtij, se ç'ka këtu për mos me ia dhënë, nuk e kujtoj. Por do të na vijë njerëzit në derë. Nuk di se çfarë ka negative këtu që s'duhet me ia dhënë me vu antenat atje. Unë s'kuptoj, cili është negativiteti nëse vë një antenë atje dhe çon sinjalin e një telefonie? Me kontratë, me vendim këshilli, me taksa të pagume. Kur ai rrin atje pa kontratë, pa taksa, pa asgjë. Unë s'e kuptoj.

-Ndue Luli: Faleminderit. Zonja Marku?

-Alfrida Marku: Me thënë të drejtën, as nuk më intereson se cili është subjekti. Edhe emrin tim në pastë unë do ta them të drejtën edhe të vërtetën gjithmonë. Nuk më pëlqen kjo që, në parim, ne e pranojmë që situata e kësaj infrastrukturës së telefonisë celulare është shtrirë edhe në zonat e banuara dhe përbën rrezik të përditshëm për qytetarët, ndërkohë themi që këtë projektvendim ta kalojmë. Pra, ne keqen e pranojmë, nga ana tjetër dorëzohemi para së keqes. Nuk e them unë, është fakt botërisht i njohur: infrastruktura e telefonisë celulare, nëse është e vendndodhur në distancë, në kundërshtim me parashikimet ligjore, shkakton rrezatim të dëmshëm jashtëzakonisht për shëndetin e banorëve. Dhe ne e dimë të gjithë, unë edhe të gjithë ne këtu, në zonat e banuara, këto antena ne i shohim në qendër të qyteteve, madje nënshtrimi i individit kundrejt një përfitimi të aty për atyshëm, ka shkuar deri aty sa i kanë leju dhe në tarracat e pallateve. Këto dy antena, në Balldren dhe Mabë, janë momentalisht 500 metra dhe më pak se 1000 metra larg zonës së banuar. Pra, janë të rrezikshme. Dhe nëse ne pretendojmë që subjekti paska leje mjedisore, kjo leje mjedisore është e vitit 2011, 15 vjet më herët, kur ato zona, ai vend ku është vendosur kjo infrastrukturë, ka qenë jo kaq e banuar sa sot. Çfarë pretendoj unë? Ne ta pezullojmë këtë vendimmarrje dhe si Këshill Bashkiak ndërmarrim një iniciativë, absolutisht kjo i tejkalon kompetencat vendore, por të ndërmarrim një iniciativë dhe të kërkojmë autoriteteve qendrore përgjegjëse të nisin një procedurë kombëtare për rishikimin e lejeve mjedisore të gjithë subjekteve të telefonisë celulare dhe rishikimin e vendndodhjes së infrastrukturës së këtyre subjekteve. Unë kam lexuar shumë për këtë temë dhe kudo në gjithçka kam lexuar, më ka bërë përshtypje një fjali e vetme: "Antenat e telefonisë celulare janë vrasësit e heshtur të përditshëm." Jo pa shkak, në qendër të qytetit të Korçës, komuniteti reagoi dhe u vendos që një infrastrukturë, një antenë e tillë të hiqej. Ju thatë që ne kemi këtu kryetarin e fshatit Mabë. Unë e respektoj, e falenderoj që ka ardhë në mbledhje, por i rikujtoj që është në konflikt interesi sepse është punonjës pranë subjektit dhe ne si Këshill Bashkiak nuk mund të marrim apriori dhe të pa ndikueshëm qëndrimet e tij në këtë mbledhje në lidhje me këtë projektvendim.

Edhe diçka që më mbeti merak: ju thatë e ke zakon të viktimizohesh për Balldrenin. Unë nuk viktimizohem për Balldrenin.

Atëherë, unë gjithmonë në Këshill Bashkiak kam një parim: të them të vërtetën, sikur i përshtatem, sikur nuk i përshtatem gjithsecilës palë. Kështu që për ta përmbyllë, për këtë projektvendim, unë kërkoj që të mos e kalojmë për votim, ndërkohë ne si Këshill Bashkiak ndërmarrim një nismë për të hequr këto antena që i kemi mes qendrave të banuara dhe deri në tarracat e pallateve dhe t'i kërkojmë autoriteteve qendrore rishikimin e lejeve mjedisore dhe rishikimin e vendndodhjes së infrastrukturës së telefonisë celulare. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Po kryetar.

-Pjerin Ndreu: Sipas kësaj logjikës së zonjës këshilltare, duhet të heqim edhe telefonat, për arsye se krijojnë probleme shumë dhe rrezikojnë jetë, edhe kur i mban te krevati, edhe kur i mban në dorë, edhe kur i mban në vesh. Pra, normalisht është kjo. Unë nuk jam kundra edhe njëherë të qartësojmë këtë histori edhe njëherë e mirë. Në qoftë se Maba është bërë problemi ku rreziku më i madh i vendosjes së një antene në sa antena ka ONE-i, atëherë ky është një problem për t'u parë. Nëse Maba do viktimizohet, domethënë për hir të kësaj, Maba do ngelet pa sinjal si zonë, sepse ne mund ta iniciojmë këtë, por nuk mund ta pengojmë këtë me e bë ligjore atë që është joligjore sot. Pra, kjo s'ka sens. Unë kam marrë pjesë në një debat. Në mes të Tiranës i ke. Rrezatimi është horizontal, jo vertical, pra nga antena në antenë, sipas ekspertëve se unë nuk marr vesh nga këto punë. Kam komunikuar vetë me njerëz dhe rrezatimi i antenave nuk shkon në vertikal, poshtë. Shkon horizontal, pra në hapësirë hapet sipër. Pra, nuk ka lidhje me atë që thoni ju. Por, nëse ka, sa të iniciojmë ne si Këshill Bashkiak që ta çojmë Shqipërinë në këmbë për këtë muhabet, se nuk jemi të parët që flasim për këtë punë, kjo është një sipërmarrje e gjatë që i bie pastaj që si antena e ONE-t, të ikë dhe antena e Vodafone-it, me të njëjtën logjikë. Dhe ne t'i lëmë njerëzit - prit njëherë se jena tu ba një studim. Unë nuk mendoj se është momenti. Ne e bëjmë ndërkohë që nuk e ndalim punën e tyre, por ne hajde ta bëjmë, jam dakord. Por jo duke ndalë punën e duke ndalë zhvillimin, se nuk ka sens kjo punë. Pra, ne jemi përballë një historie të cilën ne nuk është se e shpikëm ne në Mabë dhe ne po bëjmë një eksperiment të tmerrshëm në Mabë dhe po i vrasim atje kryeplakun e të gjithë atje. Më duket pak si e avancuar kjo që të penalizohet Maba kur gjithë territori ka të njëjtën qasje. Në Mabë kemi gjetur ne me ngritë alibinë e kësaj pune. Ata ta marrin shërbimin, pastaj, në qoftë se një grup ekspertësh, me të dhënat që i masin vetë, konkludojnë, sidomos në zonat urbane, se kjo është më problem në zonat urbane se rurale, nëse ky impakt, le ta marrim të mirëqenë atë që thu, ky impakt është i dëmshëm për qendra urbane, shumëfish më i dëmshëm, me 100 fish, 1000 fish më i dëmshëm sesa në Mabë. Tashi ne e kemi në Lezhë dhe i sulemi Mabës. E shoh të arsyeshëm shqetësimin, por nuk e shoh të arsyeshme që të nominojmë Mabën për mos t'i dhënë sinjalin e telefonisë në rastin konkret. A shqetësimin po, të gjejmë kompromis, po e kërkoj unë atje te fizika bërthamore, të vijmë këtu një grup, t'i kërkoj unë në shkrim dhe të vijmë dhe të marrin në dorë situatën, por s'është Maba rasti që ne ta bëjmë zullumin në Mabë për hir të të tjerëve.

Nuk legjitimojmë asnjë gjë, se të gjitha antenat janë të legjitimuara, se atëherë i bie që edhe ju që keni qenë bashki para meje keni bërë akte armiqësore kriminale.

E thashë edhe njëherë, unë jam dakort me shqetësimin, por jo me penalizimin e Mabës në rastin konkret. Janë dy gjëra që duhet t'i ndajmë ne.

-Ndue Luli: Faleminderit. Fjalën e ka zoti Gjiododaj.

-Kristian Gjiododaj: Atëherë, asnjëri këtu nga ne, mendoj që s'jemi eksperta të fushës për të cilësuar dëmet apo të mirat për sa i përket kësaj antenës, por duhet të jemi para faktit për diçka. Në qoftë se ka antena të tjera si puna e kësaj këtu, i kemi në qytet ose në fshatra të tjera, nuk e shoh shumë shqetësuese. Më shumë shoh shqetësuese mënyrën e procedurës, mendoj unë, që në qoftë se ne përfitojmë x të ardhura prej kësaj antene, të paktën të kishim një parakontratë këtu para që në njëfarë forme të dimë sa impakt financiar do na japë, që mund t'i referohet edhe për një të ardhme të tjerave që i kemi ne ndoshta nëpër pallate. Se mendoj, ndoshta ato antena mund të kenë x përfitime që s'ia kam idenë, gënjej. Por dhe te ne të na japin një impakt financiar. Pra,

në qoftë se kemi mundësi, të paktën të ardhurat t'i shtrëngojmë. Ah, kërkoj ndjesë se s'e paskam lexu që qenkan në projektvendim. Faleminderit.

-Pjerin Ndreu: Edhe njëherë, ne marrim zero të ardhura nga një antenë. Këtu marrim 4 milionë e 500 të vjetra dikund, në vit. Me sa antena mund të bëhen, mund të marrim 50 milionë, po e zëmë. Po marrim me përfaqësi. Pra, në kuptimin e të ardhurave, nuk kanë ndonjë peshë shumë të madhe. Më shumë peshë kanë në shërbim, në impaktin që e japin në publik. Sikur pesë veta të jenë me përdorë ONE, ne bëjmë një dëm atje në publik. Thashë edhe njëherë, jam partizan që ta adresojmë shqetësimin. Por jo zgjedhim Mabën për hit të kësaj, S'më duket normale.

-Ndue Luli: Faleminderit. Atëherë, para se sa ta hedhim projektvendimin në votim, ndjesë ju kërkoj të gjithëve se qytetari nga Maba është përfaqësues i fshatit dhe jo kryetar i fshatit. Kërkoj ndjesë unë për atë që ju thashë në fillim. Por dua të them këtë. Kisha planifikuar edhe përpara, dua të them që jam edhe me mendimin e kryetarit në lidhje me thirrjen e operatorëve të cilët kanë antena në të gjithë territorin e Bashkisë Lezhë, mundësisht sa më shpejt, në mënyrë që edhe pas studimeve që do të merren nga organet shtetërore, shëndetësore për pasojat negative që kanë antenat që janë vendosur, për shembull, nëpër pallate, nëpër shtëpi, apo në këto largësitë e tjera. Dhe pastaj të dilet me një vendim edhe në Këshillin Bashkiak, në qoftë se ato s'duhet të rrinë nëpër banesa apo të shkojnë në majat e kodrave larg banesave.

Kush është dakord për projektvendimin? Miratohet me 25 vota Pro. Këshilltarët Alfrida Marku, Gjon Marku, Soveljan Kosova, Donika Ndoj, Emanuel Perjaku votuan Kundër, 5 vota Kundër. Këshilltari Kristian Gjiodaj votoi Abstenim. Faleminderit.

Kalojmë në pikën 7, projektvendim "Për miratimin e Planit Vendor të Veprimit për Migracionin dhe Diasporën 2026-2030".

Në lidhje me këtë projektvendim, e dini që është bërë dëgjese publike.

Kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 31 vota Pro. Faleminderit.

-U largua këshilltarja Silvana Kola.

-Ndue Luli: Pika 8, Projektvendim "Për miratimin e Marrëveshjes së Konsorciumit ndërmjet "AURIVE" Agjencisë Ekzekutive Evropiane të Arsimit dhe Kulturës, Itali (koordinator projekti) dhe Bashkisë Lezhë (partner projekti) për projektin "Tempus, Spiritus i Tokës (TsiTokës)""

Në lidhje me këtë projektvendim, ka kush diçka? S'ka. Kush është dakord? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 30 vota Pro. Faleminderit.

Vazhdojmë me pikën 9, projektvendim "Për ngritjen e Këshillit Artistiko-Kulturor dhe Turistik për periudhën 2026-2028".

Në lidhje me projektvendimin, ka kush diçka? Po, zoti Marku.

-Agostin Marku: E kemi diskutuar dje, por lamë me drejtorinë. Te pika 1 duhet - miratimin e këshillit artistiko-kulturor dhe turistik pranë bashkisë Lezhë të përbërë nga sa vetë. S'ka numër të përcaktuar në vendim. Unë po them që ta rregullojmë vendimin. S'kam pyetje unë. Po them si duhet rregullu vendimi. Mandati i këshillit artistik-kulturor do të jetë i parashikuar në dispozitat ligjore në fuqi, thotë. Mandati i këshillit artistik-kulturor do të jetë dy vite. Tre, anëtarët e

këshillit shpërblehen – është në rregull. Këtu, burimet e financimit do të jetë buxheti i bashkisë Lezhë. Këtu buxhetin e bashkisë 2026. E lëmë deri këtu - buxheti i bashkisë Lezhë, se është sipas çdo viti dhe s'kemi pse ta kufizojmë me 2026. Pesë, është në rregull. Gjashtë- Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes, se s'e keni shkruajtur. Edhe me këto rregullohet, vetëm na përcaktoni numrin sa do të jetë. Me këto rregullime, vetëm na thoni numrin që ta zbardhim, unë jam dakord që miratohet.

-Paulin Zefi: Pesë anëtarë.

-Ndue Luli: Atëherë, kush është dakord me projektvendimin duke pasur parasysh edhe sugjerimet që u dhanë në lidhje me numrin edhe të tjerat? Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 30 vota Pro.

Kalojmë tek projektvendimi i parë shtesë “Për vënien në dispozicion dhe kalimin në pronësi të një apartamenti në favor të familjes përfituese, në kuadër të procesit të rindërtimit”.

Ka kush ndonjë mendim në lidhje me këtë? Zoti Emanuel?

-Emanuel Perjaku: Vetëm një pyetje kam, kur është shpallur shtëpia e zotërisë monument kulture dhe për çfarë është monument kulture?

-Pjerin Ndreu: Një pjesë e asaj shtëpisë ka pasë hyrë te monumentet e kulturës. Nuk është një monument kulture si puna e atyre që kemi në qendër. Por në kushte dhe rrethana pak të çuditshme në fakt, është një gjë e tillë. Me thënë të drejtën, ne s'e kemi konsideruar ndonjëherë, por ndërkohë që duhet me hy me ndërtu, ne kemi shfrytëzuar një banesë që kemi nga Enti i Banesave dhe ia japim zotërisë. Ai ka rënë dakord me e marrë. Kështu heqim njërin nga lista e të pastrehëve të tërmetit. Pra, çdo kalim shtëpije një x personi është pozitive se hiqet nga lista dhe hiqet nga lista e dhënies së bonusit të qerasë.

-Ndërhyn z. Paulin Zefi duke thënë se në qoftë se ka paqartësi në lidhje me monumentin , mundet të spjegojë.

-Ndue Luli: Një sqarim këtu nga zoti Marku.

-Agostin Marku: Unë kam vetëm prapë në fund te pika katër, mos ta kufizojmë, se po e kufizojmë kur themi pas konfirmimit ligjor. Prefekti shprehet, nuk shprehet, është puna e tij. Ne themi 10 ditë pas shpalljes, e lëmë këtu te ligji i vetëqeverisjes vendore të ndryshuar. Hiqe këtë dhe pas konfirmimit ligjor nga institucioni i prefektit. Se i bëjmë kufizim vendimit edhe nuk është mirë. Po mund të mos shprehet ai fare, s'e sheh të arsyeshme. Vendimi hyn në fuqi.

-Ndue Luli: Ky është akt individual, kështu që nuk kalon te prefekti. Fjalën e ka zonja Marku.

-Alfrida Marku: Meqë jemi tek kjo çështje, patjetër që çdo nismë që ndihmon në rehabilitimin e pasojave të tërmetit duhet mbështetur. Unë kam detyrimin që mbi bazën edhe të disa kërkesave, shqetësimeve të disa banorëve, të adresoj dhe të kem një përgjigje për disa çështje të cilat lidhen pikërisht me tërmetin. Përveç rindërtimit, ka pasur edhe një kategori tjetër dëmsh për shpërblimin e dëmit. Edhe shumë familje kërkojnë një përgjigje kur mund të bëhet e mundur marrja e pagesave për riparimin e dëmeve nga tërmeti. Patjetër që kjo kërkon angazhim të instancave të tjera, por si bashki keni detyrimin për ta adresuar.

Një tjetër problematikë, kur pritet të finalizohet regjistrimi i pallateve të rindërtuara dhe për pasojë pajisja e këtyre banorëve me dokumentin e pronësisë së apartamentit përkatës në të cilin ata jetojnë tashmë.

Së treti, në shtator të 2025-s, ne si këshill bashkiak kemi marrë dy vendime nëpërmjet të cilëve autorizojmë bashkinë Lezhë për ndjekjen e procedurave pranë komisionit shtetëror të rindërtimit për rindërtimin e banesave, 41 banesave individuale. Edhe unë kërkoj në emër të këtyre banorëve të di nga ana juaj se në ç'fazë jemi sa i përket kësaj procedure dhe kur pritet që të nisë zgjidhja e këtij problemi.

Së fundmi, jo për nga rëndësia, unë e mora një gjysmë përgjigje, por në emër të banorëve kërkoj që të jetë diçka më e detajuar çështja e pallatit ku ka qenë ish-BKT-ja dikur në qendër të qytetit. Ne si këshill bashkiak patëm marrë një nismë, kuptohet me propozimin tuaj, që rindërtimi i këtij pallati të përfshihet në buxhetin e vetë bashkisë Lezhë. Sa i përket kësaj çështje, kur pritet që të nisin punimet edhe banorët të marrin zgjidhje për këtë problematikë? Faleminderit.

-Pjerin Ndreu: Nga e fundit, nesër. Mund të shkosh aty, sepse është prokuruar, është mbyllur me të gjitha ato që duhen. Kur them nesër, këtë ditë fillojnë punimet.

E dyta, ato që thoni ju, janë aplikimet e dyta që janë bërë një vit e ca mbrapa. Ne si bashki i kemi adresuar të gjitha. Sepse ka një problem që duhet ta kuptojnë gjithë këshilltarët në rastin e pozicionit të bashkisë në raport me tërmetin. Pra, bashkia është nominuar si njësi nga akti normativ i qeverisë për t'u marrë me këtë proces, por ata që kanë vendosur shkallën e dëmtimit janë inxhinierët, që është akti i ekspertimit që kanë bërë inxhinierët e ndërtimit, nuk është Pjerin Ndreu. Këto kanë shkuar në qeveri dhe ne i kemi adresuar dosje për dosje. Qeveria ka pa në shumë vende që është abuzuar. Dakord? Se tashi të vish pas një vit e dy muaj, tre muaj, të vish këtu e të thuash m'u prish shtëpia, kur ti ke qenë aty e s'ke ardhur, e kanë diskutuar dhe në qeveri kanë menduar që nuk janë reale shumica e këtyre. Unë nuk e di se çfarë ka ndodhur. Kjo për mendimin tim, nuk ka gjasa që të kalojë. Se qeveria është duke i konsideruar, s'është duke i konsideruar, ne e kemi ngritë si shqetësim. Ne i kemi kërkuar qeverisë, që të na hapë rrugën ne që me fondet tona me programin e strehimit, dhe ato t'i përdorim, edhe me lejen e ndërtimit që po vijmë, ne kemi lekë mjaftueshëm që t'i bëjmë të gjitha. Duhet të dalë një VKM për këtë gjë. Në parim, kemi ra dakord. Tani besoj se nuk do vonojë shumë dhe ne do e zgjidhim këtë problem. Ne Lezha jemi në avangardë të zgjidhjes, se jemi të vetmit që kemi hyrë me fondet tona për të bërë pallatin aty, për ta ezauruar. Dhe me 45 shtëpitë, ne e ezaurojmë këtë histori, dhe nuk kemi më punë me adresimin e problematikës për tërmetin.

Regjistrimi ka filluar.

-Ndue Luli: Kush është dakord me projektvendimin? Ju lutem, kartonet. Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë.

Vazhdojmë me pikën 2 shtesë, Projektvendim "Për një ndryshim në VKB nr. 115, datë 26.08.2020 "Për miratimin e listës së subjekteve përfituese për grante rindërtimi për shtëpitë individuale dhe banesa në ndërtesa (pallate), me shkallë dëmtimi DS4 dhe DS5, sipas analizave të thelluara të Institutit të Ndërtimit në Bashkinë Lezhë".

Ka kush diçka? S'ka. Atëherë, kush është dakord? Ju lutem, kartonet. Miratohet me votat Pro të të gjithë këshilltarëve prezentë, 30 vota Pro.

Kalojmë tek projektvendimi i fundit, “Për përcaktimin e datave të reja për zgjedhjen e anëtarëve të kryesisë dhe të kryetarëve të fshatrave, në fshatrat Tresh, Kodërmulliri dhe Krajën”.

Siç jeni në djeni, janë tre fshatra në të cilët zgjedhjet nuk janë zhvilluar fare. Tek pika “Të ndryshme” do ju raportoj shkurtimisht për ato që janë zhvilluar. Në lidhje me këtë projektvendim, kush ka ndonjë mendim? Po kryetar.

-Pjerin Ndreu: E para e punës, për faj edhe të administratorëve, nuk janë publikuar listat se kush merr pjesë në votim. E dyta, me çfarë konstatoj unë, me katër vetë zgjidhet kryetar fshati. Atje lista mund të ketë 150 vetë, listë e zgjedhësve mbi 18 vjeç.

Tashi, e di si është problemi? Ne i kemi hapur krah një procesi për të cilin unë nuk kam pasur pikë leverdie personalisht me hy me i futë në kolaps me u zënë me njëri tjetrit fare. Dakord? Se i kisha mbaj të emëruar ashtu siç i kisha.

Por kjo nuk do të thotë që procedurat e zgjedhjeve duhet të bëhen me rreth familjar aty. Unë nuk mendoj që këshilli duhet të bjerë në këtë lloj niveli. Kush ka bërë zgjedhje me pjesëmarrje, me votime të rregullta, me afishime listash, me marrje njoftim, me të gjitha procedurat e rregullta, sikur është, dakord. Po ti të mos kesh 20 veta aty për të votuar e të vish e të më thuash mua, unë jam kryetar i fshatit, më falni, po ky këshilli nuk duhet të bjerë në këtë lloj gabimi. As unë nuk duhet të bie në këtë gabim, askush. Se nuk është ky qëllimi, që të zgjedhësh njërin që ka mbledhur 4-5 shokë, kaq u mblodhën, edhe unë u bëra kryetar fshati. Ky nuk është proces me u tall. Se ke përgjegjësi para banorëve. Dhe në qoftë se nuk je i zoti me pru në votim, të paktën një kuorum optimal njerëzish me të votu, atëherë... Atëherë çfarë do të bëjmë ne si këshill? Më vjen shumë keq, po unë i kërkoj këshillit të mbajë qëndrim. Edhe këshilltarët të mos më përplasni mua, se të gjithë vijnë te unë. Këshilltarët nuk duhet të firmosin nëse nuk janë afishu listat, nëse nuk janë marrë njoftimet, nëse nuk ka një kuorum optimal. Kemi rast që nuk dorëzon vulën në fshatin Kaluer. Sepse po ndodhin fenomene që janë të çuditshme dhe ne si këshill duhet të mbajmë qëndrim. Dhe unë i kërkoj këshillit që të mbajë qëndrim dhe këshilltarët mos të firmosin gjëra kot atje.

-Ndue Luli: Zoti Artan.

-Artan Ndreu: Përhëndetje të gjithëve. Zoti kryetar, e shpjegove shumë qartë por faji është i këshillit. Jo kot herën tjetër në Tresh ju kam thënë, keni shku, keni bërë ngatërresa, ju kanë sha, ju kanë ofenduar, ju shkoni me bë hile, jo me të ba zgjedhje. T'i bëj unë në krejt bashkinë e Lezhës zgjedhjet, në qoftë se ka problem. Si të shkosh me bë hile, hile përfundon. Unë isha në Rrilë, se po e them para këshillit, kam pa njerëz edhe me armë. Administratorja është shumë e nderume, ajo nuk e dinte se ne kena miratu në këshill për me i administru administratori zgjedhjet, na jena vetëm vëzhgues. Ju ka marrë ju në telefon. Edhe ju nuk na çoni as listën, kur më ke thënë mu, më ke thënë sot për sot.

-Pjerin Ndreu: Pse i keni bërë zgjedhjet atëherë, pa lista?

-Ndue Luli: Të sqaroj unë, po mbaro diskutimin.

-Artan Ndreu: Ju as keni nda lagje, i keni çu njerëzit në katastrofë.

-Pjerin Ndreu: Kjo nuk është kompetencë e imja. Strukturat e mia vijnë në dispozicion që ta dini. Kjo është kompetencë e këshillit. Unë jam duke ngritë një problem mbi bazën e

shqetësimeve që më kanë ardhë me sms, me telefon. Me sa di unë, Rrila ka qenë më e sakta nga fshatrat në pjesëmarrje.

-Artan Ndreu: A ka pasë problem? Unë kam pa njerëz me armë aty.

-Pjerin Ndreu: Duhet të kishit njoftu policinë.

-Ndue Luli: Supozime mos të bëjmë, zoti Artan, por vazhdo, mbaroje diskutimin.

-Pjerin Ndreu: Ju kërkoj, se shqetësimi po përplasat te unë. Dhe unë e kam biseduar dhe me kryetarin, edhe me nënkryetarin këtë shqetësim. Dhe unë nuk bëj luftë me politikë këtu, por të shkosh e të zgjidhesh me dy vetë, mua nuk më duket e arsyeshme që duhet të bjerë këshilli...

-Ndue Luli: Fjalën e ka zonja Prendaj.

-Rajmonda Prendaj: Atëherë unë duke qenë se në zgjedhjet e kryesisë së fshatrave, kam qenë në komision më përpara, për arsye personale, kërkoj të zëvendësohem.

-Ndue Luli: Okej, ta shqyrtojmë në fund. Atëherë, para se t'i jap fjalën këshilltarit Gjiodaj, duhet të sqaroj. Më vjen keq shumë, jo si kryetar i këshillit, por si kolegu juaj, që shumë anëtarë të këshillit pyesin për procedurat se si duhet vepruar për zgjedhjen e kryetarëve dhe të kryesive të fshatrave, në një kohë që ligji "Për Vetëqeverisjen Vendore", por sidomos rregullorja e këshillit e miratuar prej nesh këtu, e ka të sanksionuar aq bukur, aq qartë, se si veprohet në mbledhjet e lagjeve apo të fshatit për zgjedhjen e anëtarëve të kryesive, por edhe të kryetarëve të fshatrave. Dhe ka të drejtë ndonjë edhe këshilltar që e thotë, por faktikisht jemi brenda të gjithë si këshill këtu, që kemi të meta në aspektin e menaxhimit, të organizimit, pasi anëtarët e këshillit nuk janë vëzhgues, por janë komisioni i përcaktuar nga këshilli bashkiak. Dhe nuk ka nevojë, se u përmend këtu se s'e kam ditur, nuk ka nevojë që të njoftohet këshilltari se filan ditë ke mbledhjen ose zgjedhjet në fshatin X, sepse në mbledhjen e këshillit është vendosur me emër mbiemër se kush është komisioni, si nga këshilltarët e majtë në komision, ashtu edhe nga këshilltarët e djathtë. Datën ka të drejtë secili anëtar komisioni, të bashkëpunojë, sepse jemi për me i shërby komunitetit, nuk është puna me marrë njoftimin se e ke filan datë, por me pyet. Atëherë në këtë datë unë hyj në lidhje me kryetarin e njësisë, me shokët e tjerë që janë këshilltarë, se cila do të jetë ora e lagjes X, e lagjes Y, e lagjes Z, dhe vazhdon puna siç duhet. Mos prisni kurrë që në një vendim këshilli, i cili përcaktohet me datë, me emër, dhe të marrë dikush në telefon, prapë: "A je tu shku atje," sikur je tu shku me rregullu ose me bë punën e tij personale. Është me vendim këshilli. Me hile është në qoftë se ndryshon data, futet dikush me ndryshu datën sipas qejfit, që ne kemi pasur raste të tilla dhe i kemi anuluar.

Fjalën e ka zoti Gjiodaj.

-Kristian Gjiodaj: Atëherë, përse i përket zgjedhjeve, unë isha prezent në një fshat dhe unë mendoj që ka problematikë, nuk e di sa na e lejon ligji apo sa mund të ndërhyjmë, të përcaktojmë ne si këshill në rregullore. Që kam pa nga më të ndryshmet, që ky është i kësaj lagje, s'i lejohet, ky s'është, dhe pastaj këshilltarët nganjëherë mundohen edhe me ik me të drejtë. Se vetë procedura s'është aq e rregullt sa duhet, ku e vërteton këshilltari se është i lagjes, a s'është i lagjes. Një, e para. E dyta, duhet të përcaktojmë ne ndoshta me një rregullore të brendshme një numër minimal ose maksimal. Me një përqindje. Na ka qëllu me na ardhë katër veta në një lagje

dhe kanë votuar atë që thotë kryetari i bashkisë. Por kur s'e ka rregullorja të shkruar.... A na lejën ligji me ba një rregullore të brendshme ne? (i drejtohet z. Agostin Marku)

-Ndue Luli: Është bërë rregullorja për këtë punë, është miratu, të lutem mbaroje diskutimin.

-Kristian Gjidoaj: Kaq kisha.

-Agostin Marku: Nuk doja me fol në fakt, është kohë e humbur, po e përsëris, është kohë e humbur me u marrë me këtë punë e pikërisht sot. Tani, të gjithë jemi këshilltarë edhe marrim pjesë në vendimmarrje. Kur miratohen vendimet, e paktën vendimet kur këshilltarët janë në përbërje dhe duhet të merren direkt me zbatimin e vendimit, kapni e lexoni të zezën në të bardhë. Edhe e shihni aty, edhe datën, edhe si njoftohen, edhe kush është në komision, edhe kush janë kompetent për ta bërë atë punë se i keni të qarta. Sa i takon pjesëmarrjes. Nuk mund të bëjë këshilli rregullore në kundërshtim me ligjin. Ligji e përcakton. Është handicap. E mora fjalën vetëm me të ba shpjegim ty, se ke qenë kryetar këshilli. Ligji e ka të përcaktuar qartë, për mua është handicap, nuk kërkohet 50% për presidentin e republikës, për qeverinë, për kryetarin e bashkisë. Ligji thotë 50% e zgjedhësve të fshatit, duhet të marrin pjesë, pra që do të thotë, nga mosha 18 vjeç e lart, nuk është me kryefamiljarë, nuk është me fise, nuk është me grupe të caktuara ku ta di unë. Dhe administrimin e infrastrukturës e bën gjithmonë organi ekzekutiv që është bashkia. Çështjen e vendimmarrjes e ka këshilli që janë të deleguarit që janë sipas zonave. Lagjet janë ndarë me vendim këshilli, sepse ligji e përcakton. Me vendim këshilli janë ndarë lagjet. Tani, kufizimet e lagjeve s'mund t'i vendosë këshilli, se ne s'dimë gjë se ku janë kufizimet e si janë. Po ato janë mbi bazën e traditës, mbi bazën e historisë, etnive, pozicioneve gjeografike, ka shumë gjana që hyjnë aty, por prapë mund të hyjnë organet ekzekutive dhe ndahen ato. Do të thoni ju, po s'u bëkan zgjedhjet. Në gjykimin tim, nuk bëhen zgjedhjet në bazë të ligjit. Pse s'bëhen në bazë të ligjit? Sepse nuk sigurohet pjesëmarrja. Dhe pjesëmarrja nuk është faji i kërkujt, as i këshillit, as i bashkisë, por është i ligjit që e ka përcaktuar atë minimum që thotë 50 plus 1%. Dhe këtë nuk e rregullojmë dot ne. Faleminderit.

-Pjerin Ndreu: Më falni edhe njëherë. Ligji, normalisht është i bërë pak me handicap, se ne nuk e arrijmë kurrë atë. Por edhe me katër vetë nuk bëhet ajo punë. Është absurd.

-Ndue Luli: Zoti Ndreca.

-Erin Ndreca: Mendoj që të gjithë projektvendimet nga i pari tek i fundit meritojnë seriozitet, sepse nganjëherë notat humoristike që i japin disa, jo të gjithë, e ulin seriozitetin j. Si përfaqësues i grupit që është maxhorancë, që përpara kam qenë i një mendimi që të gjithë përfaqësuesit anëtarë të këshillit bashkiak kanë qenë shumë seriozë në zgjedhjet e kryetarëve të fshatrave. Por kam qenë i mendimit që diçka që nuk ndodh me të parën, nuk është mungesë e anëtarëve të këshillit, është mungesë e shumë e shumë gjërave, dhe prandaj kam qenë i parimit që duhet të zgjidhen nga kryetari i bashkisë. Për arsye se e kam prekë realitetin vetë në ato zona dhe në ato zona ka ndodhur që për arsye nga më të ndryshmet, nuk është realizuar zgjedhja, mbase për fajin e dikujt, mbase për fajin e askujt, dhe nuk kam patur pritshmëri që të ndryshojë herën e dytë apo të tretën, sepse atje ku ka zgjedhje, zgjedhje bëhen. Atje ku nuk ka njerëz, zgjedhjet nuk kanë si realizohen, dhe parimisht i qëndroj përcaktimit të ligjit. Sado që të përpiqemi t'i japim doza që jo hilja, jo pahilja, jo kjo, jo ajo, unë jam gjithmonë i parimit, ku dakord, unë i qëndroj ligjit dhe duhet të jap dhe diçka logjike. Nëse kryetari i bashkisë ka autoritet të zgjedhë administratorët që janë mbi kryepleqtë, atëherë kryetari i bashkisë, nuk ka asgjë të keqe, në këto zona ku nuk

zbatohet ligji, nuk ka pjesëmarrje, në këto zona ku ka shkelje të procedurave, unë ju ftoj të gjithëve që këto zgjedhje të mbajmë një qëndrim dhe mos t'i quajmë, sepse me idenë që po mbajmë zgjedhje, po bëjmë gjëra që nuk na shkojnë. Prandaj, atje ku mendohet dhe atje ku ka shkelje të procedurave, unë mendoj që të mbajmë qëndrimin tonë dhe të mos i njohim. Faleminderit.

-U largua këshilltari Emanuel Perjaku.

-Ndue Luli: Po kryetar.

-Pjerin Ndreu: Që të bëjmë një qartësim edhe njëherë.

Problemi është që këtë zgjedhjen me votim e kam iniciuar unë tre herë. Mua nuk më intereson fare, s'm'impakton fare, se kjo teoria e kryetarit të fshatit na impakton politikisht, fare nuk më impakton. Le të zgjidhen, por jo të vetëzgjidhen. Po të jetë puna të vetëzgjidhen, ligji ma le mua, por unë nuk kam qejf ta bëj ashtu. Pra, nuk është dëshira ime ta bëj ashtu, po edhe me shku me u tall me procesin, kur më vijnë mua të dhëna, që janë anormale, që s'kanë lidhje fare me asnjë lloj procedure, shkojnë këshilltarët atje dhe nuk mbajnë qëndrim, më vjen shumë keq, por unë nuk mund të marr koston e kësaj, se bëhen ankesa, se që kur u zgjodhën radhën e parë, mund të kem marrë mbi 30 ankesa. Kështu unë nuk duhet të përballem për këtë punë, por unë i kërkoj këshillit që të mbajë qëndrim, të shkojë dhe të korrektojë procesin dhe të kërkojë zbatimin një e për një të rregullave. Në qoftë se ka administrata e njësisë një gabim, le të hyjmë ne, këshilli të më drejtohet, o kryetar, administratorët e tu nuk e bëjnë këtë punë, të hyjmë ne në lojë dhe ta bëjmë.

-Ndue Luli: Një sqarim të vogël para se të jap fjalën. Duhet të dimë se sot ne nuk kemi në shqyrtim projektvendimin për zgjedhjet e kryetarëve të fshatrave sipas vendimit që morëm në muajin janar, por kemi këtë projektvendim i cili bën fjalë për zgjedhjet e kryetarëve të fshatrave në tre fshatra që nuk janë zhvilluar fare zgjedhjet. Besoj se e kuptoni mirë. Në lidhje me fshatrat e tjerë ku janë zhvilluar zgjedhjet, se si janë zhvilluar, do e shikojmë, do analizojmë mbledhjen e ardhshme, pasi të mbarojnë dhe këto tre fshatra dhe do vendosim si këshill se si do të shkojë puna. Besoj se më kuptuat.

Zoti Hila, pasi të mbarojmë projektvendimin, e ke fjalën. (I drejtohet qytetarit të pranishëm në mbledhje me kërkesën e tij).

Zoti Kosova e ka fjalën.

-Soveljan Kosova: Nuk e kuptova homologun tim, përfaqësuesin tuaj, që tha ta hedhim poshtë këtë procesin që është zhvilluar deri sot, kur organizimin e zgjedhjeve për kryepleqtë, njoftimet, listat, infrastrukturën e ka administratori dhe gjysmën e komisionit e keni ju. Tani do me hedh poshtë ato vendime që janë marrë. Kyt s' e kuptova fare.

-Ndue Luli: Unë sqarova se s'është në shqyrtim ajo punë. Besoj se më kuptove dhe nuk do merremi me këtë.

-Pjerin Ndreu: Pra, mund ta sqaroj unë se... Atje ku po bëhen zgjedhje sot, janë të emëruarit e mi, se për mua ishte më e thjeshtë me i mbajtë ashtu. Që të jesh i qartë. Më fal edhe njëherë.

E dyta, kam marrë shqetësime përditë nga disa paqartësi në procedurë dhe ka të drejtë gjithsecili me bërtitë. Tani, sa për administratorët e mi, e thashë vetë, e pranova vetë, nëse ata nuk kanë realizuar atë, kjo s'do të thotë se këshilltarët duhet të shkojnë aty e të bëhen palë me një zgjedhje formale aty. E ka fajin administratori, e marr unë si procedurë. E ka fajin personi që do me u zgjedhë me katër vetë, se s'është i zoti me pru nja 20 vetë aty me votu për të, është problem i atij, sepse kjo bëhet edhe me lobing aty, votat nuk ia çoj unë te dera atij. Po edhe që ne të shkojmë në nivelin e katër votave, pesë votave, gjashtë votave, për me bë një kryetar fshati e s'përfaqëson asgjë përveç shtëpinë e vet, kjo nuk e rregullon këtë situatë. Përkundrazi.

-Ndue Luli: Po zonja Marku.

-Alfrida Marku: Personalisht jam pjesë në një proces, më duket, në njësinë administrative të Balldrenit. Në mbledhjen e parë për arsye objektive e kam pasur të pamundur të marr pjesë, por unë po e shpreh publikisht qëndrimin tim. Në mbledhjen e radhës do marr pjesë, por në respektim të ligjit që aty thotë zgjedhja e kryetarëve të fshatrave, detyrimisht realizohet nëse marrin pjesë më shumë sesa 50% e listës së zgjedhësve, absolutisht unë nuk do të bie dakord me një procedurë të tillë. Diskutimi që ne bëjmë, mendoj që nuk e zgjidh ngërçin ku është situata. Ngërçi është tek parashikimi ligjor tek ligji 139 i vitit 2015, por është koha për ta zgjidhur, për ta adresuar. Sa kohë diskutohet për një rishikim të reformës, patjetër që, pse jo, disa prej nesh ta adresojnë si propozim që kjo klauzolë në këtë ligj të ndryshohet. Në raundin e parë të pretendohet që të marrin pjesë 50 plus 1% e listës së zgjedhësve, që është e pamundur. Ama nëse nuk realizohet në mbledhjen e parë, atëherë kryetari i fshatit të zgjidhet, pse jo, me shumicën e banorëve të fshatit, prezent në datën e zgjedhjes.

-Ndue Luli: Qartë. Për projektvendimin në fjalë të cilin lexuam, duke marrë parasysh kërkesën e këshilltares për tërheqje nga komisioni për fshatin Tresh, mendoj që në vend të saj, përderisa ajo u tërhoq, të jetë këshilltari Marin Suta. Kuptohet që kryetarët e tre njësisive që mbulojnë këto tre fshatra, gjatë kësaj kohe, që nuk është e shkurtër, është mbi 20 ditë, të marrin masat e duhura sipas ligjit për të krijuar infrastrukturën e duhur për zgjedhje të ligjit të kryetarëve dhe kryesive të këtyre fshatrave.

-Doli këshilltari Kristian Gjidodaj.

-Ndue Luli: Kush është dakord me projektvendimin? Miratohet me 27 vota Pro. Këshilltari Erin Ndrea votoi Kundër.

Atëherë, kalojmë te pika të ndryshme.

Fjalën te pika të ndryshme do e filloj unë. Dhe pika e parë që kam unë te "Të ndryshme" është një informacion i cili ju ka ardhur, që ka të bëjë me zgjedhjet që janë bërë sipas kalendarit që morëm në mbledhjen e këshillit të muajit janar, ku janë specifikuar të gjitha rastet sipas fshatrave dhe lagjeve. Kjo thjesht është vetëm për t'ju vënë në dijeni, që po ta shikosh me kujdes këtë informacion, vihet re dukshëm një pjesëmarrje e ulët, një mosrealizim tërësisht në bazë të ligjit të zgjedhjeve të anëtarëve të kryesisë dhe të kryetarëve të fshatrave, por për të marrë në shqyrtim zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave, do jetë mbledhja e radhës e muajit mars, pasi të realizojmë edhe zgjedhjet në këto tre fshatra që morëm vendim. Dakord?

Fjalën e ka tani zoti Prend Hila, i cili ka kërkuar me shkrim për të marrë pjesë në mbledhjen e këshillit sot. Fjala për ju, tre minuta.

-Zoti Hila ngriti shqetësimin e tij në lidhje me zgjedhjet për kryetar fshati në fshatin Tresh, për të cilin na ka bërë shkresë disa herë dhe është ankuar dhe në platformën e Bashkëqeverisjes dhe te Avokati i Popullit, të cilëve u kemi kthyer përgjigje.

-Ndue Luli: Një sqarim për këshilltarët. Vërtet ka fituar në lagje si anëtar i kryesisë së fshatit, atje janë pesë lagje, por është shkelur vendimi i këshillit bashkiak duke u bërë në datë jo të përcaktuar nga vendimi i këshillit bashkiak. Dhe prandaj fshati është i tëri në zgjedhje. Dhe lagjet e tjera s'kanë qenë bërë fare. S'janë bërë fare zgjedhjet. Si do të dilte kryetar fshati, zotëria në fjalë, kur ka dalë vetëm anëtar i kryesisë së fshatit? Kjo është arsyeja. Nuk kemi asgjë me qytetarin. I urojmë suksese në datën 17 mars, mos gaboj. Ishte në projektvendim që do bëhen zgjedhjet në fshatin Tresh. Le të kandidojë prapë dhe pastë fitoren.

Fjalën e ka zoti Gjinkola.

-Zoti Gjinkola ngriti si shqetësim, çështjen e zgjedhjes së administratorëve të pallateve.

-Ndue Luli: Fjalën e ka zonja Marku.

-Alfrida Marku: Dy problematika i kam drejtpërdrejt nga banorët e dy lagjeve të qytetit të Lezhës.

Së pari, banorët e zonës ku njihet si pallatet e ish-përndjekurve, rruga “Pjetër Arbnori”, në lagjen Besëlidhja, më kanë shprehur shqetësimin për disa problematika në lagjen e tyre. Unë besoj që në projektin për sistemimin e rrjetit të kanalizimeve, edhe lagjja e tyre është e përfshirë, sepse ata realisht kanë shumë probleme me sistemin e kanalizimeve. Në këtë lagje është emergjente marrja e masave për një proces tjetër për lirimin e hapësirave publike. Janë shumë objekte, shumë rrethime aty, edhe pa leje të cilat i pengojnë këta banorë që të shfrytëzojnë hapësirat publike. Njëkohësisht, për arsye që edhe kuptohen, s'është nevoja t'i them, këto objekte dhe baraka janë kthyer edhe në vende të tejet të ndotura dhe burim infeksionesh. Pra, ju lutem që ta verifikoni këtë lagje, të ndërmerrni seriozisht një nisëm tjetër për lirimin e këtyre hapësirave publike.

Së dyti, problematikë tjetër që më vjen nga lagjja Sënderberg e qytetit të Lezhës është një pallat, pallati 16 i emërtuar. Në 2008, ai pallat është deklaruar i pabanueshëm. Kuptohet, rrjedhimisht është me rrezik për banorët. Pas tërmetit të vitit 2016, gjendja infrastrukturore e këtij pallati është rënduar akoma më shumë, pra përbën rrezik të shtuar për banorët. Pse e them këtu? Aktualisht, në atë ndërtesë të pabanueshme jetojnë rreth tre familje. Çfarë kërkojnë banorët e këtij objekti? Ata kërkojnë që fillimisht të jenë prioritet për Bashkinë Lezhë, që të trajtohen në skemën e bonusit të qerasë, deri në një zgjidhje që ata të gjejnë mundësitë për të blerë apo ndërtuar një tjetër banesë. Gjithashtu, ata kërkojnë lehtësi procedurale dhe fiskale sa i përket mundësisë për leje ndërtimi, por nga ana tjetër, pse jo, propozojnë që të jenë në vëmendjen e institucionit të Bashkisë Lezhë për zhvillimin e ndonjë projekti të mundshëm, ku njëkohësisht këtyre banorëve t'u mundësohet sipas pjesës takuese edhe e drejta e pronës në objektet e mundshme që mund të ndërtohen aty. Kaq kisha.

Unë mendoj që këto dy problematika përfshijnë një numër të lartë familjesh. Janë në qendër të qytetit të Lezhës. Njëra është në shëtitore, tjetra është në hyrje të lagjes së Sënderberg. Unë shpresoj që nga ana e bashkisë do të verifikohen edhe merren masa. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Zoti Trashaj, shkurt të lutem. Kam dhe unë një gjë të shkurtër pastaj.

-Alfons Trashaj: Te lagjja Gurra, ka një korsi biçikletash aty afër, te rruga e spitalit. Është ankesë e qytetarëve. O të rrijë korsi derisa të rikualifikohet qyteti, o të jetë parking. Po gjobiten shoferat aty. Po tashi t'i vihet një tabelë që është korsi biçiklete dhe nuk lejohet parkimi.

E dyta, Lezha është kthyer në kantier punimesh, shumë të bukur, po ndërtohet. Firma të hedhë ujë që mos të bëhet pluhur,

E treta e fundit, parkingjet e makinave me qera dhe parkingjet e makinave që s'kanë targa, dhe i kanë në parking, zënë vendin e parkingut kot. Të shikohet. Të hiqen, të lirohet parking për atë që punon, për atë që paguan taksën. Kaq kisha. Faleminderit.

-Ndue Luli: Faleminderit. Atëherë diçka kisha dhe unë meqënëse kemi dy nënkryetaret e bashkisë këtu.

Dihet që Lezha është përfshirë në punime të forta për sa i përket kanalizimeve të ujrave të bardha. Problem mbetet shumë sipas disa ankesave të qytetarëve, për sa i përket trafikut të makinave, ku makinat ndalen vend e pa vend me kry punë të ndryshme si para bankave e tjera e tjera dhe pengojnë deri në 10 minuta, ndoshta bllokojnë rrugën, pasi janë me një sens një pjesë e rrugëve. Dhe mendoj që policia bashkiake gjatë kësaj kohe t'i kushtojë më shumë rëndësi qytetit, në mënyrë që mos të ketë agravim. Edhe ambulanca, një ditë thotë një qytetar, që ka mbetur 10 minuta në trafik, se ishte bllokuar në të gjitha anët, derisa ia hapën ato nga mbrapa për me kalu nga mbrapa me shku në një rrugë tjetër. Kështu që policia bashkiake ta mbajë parasysht më shumë.

Ka tjetër? S'ka. Atëherë ju falenderoj ju që qëndruat deri në fund. Shumë faleminderit.

Shënim: Mbledhja u transmetua live në Facebook në faqen "Këshilli i Bashkisë Lezhë".

SEKRETARI

Floride Çunaj


KRYETARI

NDUE LULI
